



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Belsh**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Mbi auditimin financiar**

**të ushtruar në**

**BASHKINË BELSH**

**Tiranë, korrik 2024**

## PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4 – 7</b>
	<i>a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim</i> <i>b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij</i> <i>c. Qëllimi i auditimit</i> <i>d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave</i> <i>e. Nga shqyrtimi i evidencave</i> <i>f. Paraqitja e gjetjeve kryesore</i> <i>h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore</i>	
<b>I.1</b>	<b>KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT</b>	<b>6 - 7</b>
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>7-12</b>
<b>1.</b>	<b>OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA</b>	<b>7 - 12</b>
	<i>-Objektivat e Qëllimi auditimit</i> <i>-Identifikimi i çështjes</i> <i>-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese e audituesve</i> <i>-Kriteret e vlerësimit</i> <i>-Standardet e auditimit</i> <i>-Metodat e auditimit</i> <i>-Dokumentimi i auditimit</i>	
<b>III</b>	<b>Përshkrimi i auditimit</b>	<b>12 - 50</b>
<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Belsh</b>	<b>12 - 13</b>
<b>2.</b>	<b>Përshkrimi i auditimit, sipas drejttimeve të auditimit</b>	<b>13 - 50</b>
2.1	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	<i>13 – 21</i>
2.1.6	<i>Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimin e tyre.</i>	<i>21 - 27</i>
2.2	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	<i>27 - 46</i>
2.3	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave)të transferuara sipas VKM.</i>	<i>47 - 50</i>
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME</b>	<b>51 - 58</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>59 - 74</b>

## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ALUIZNI-t</b>	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonime
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>OE</b>	Operator Ekonomik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e re e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me Bashkinë Cërrik, në jug me Bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me Bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit.

Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19.503 banorë dhe densitet prej 99.28 banorë për km<sup>2</sup>, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32.389 vetë dhe densitet prej 168.88 banorë për km<sup>2</sup>. Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km<sup>2</sup>.

Për vitin 2023, është miratuar buxheti vjetor me VKB nr. 70, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1510/1 prot., datë 30.12.2023 si dhe VKB nr. 2, datë 24.01.2023 “Për miratimi i të ardhurat e trashëguara dhe granti i trashëguar nga viti 2022”.

Gjithashtu për PBA e viteve 2023 - 2025 janë realizuar fazat e përgatitjes dhe janë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 18, datë 24.03.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 406/1 datë 03.04.2023.

Projektbuxheti Afatmesëm për vitet 2023 - 2025 është miratuar përkatësisht me VKB nr.29, datë 08.04.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 503/1, datë 14.04.2022 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr.2048, datë 20.07.2022.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 16 (gjashtëmbëdhjetë) programe buxhetore.

Ndryshimi në rritje të vlerës buxhetit të vitit 2023 nga plani i buxhetit të vitit 2023 në PBA ka ardhur si pasojë e të ardhurave dhe grantit të trashëguar nga viti 2022, në vlerën 93,711 mijë lekë dhe nga transfertat e pakushtëzuar e cila për vitin 2023 është për shtesë në vlerën 13,840 mijë lekë. Për sa i përket shpenzimeve, rezulton se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime zënë 38 % ose në vlerën 162,137 mijë lekë, shpenzime korrente zënë 24.6 % ose për vlerën 105,708 mijë lekë, transfertat zënë 2% ose për vlerën 8,435 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 35.4 % ose në vlerën 153,841 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar me Urdhrin e kryetarit të Bashkisë nr. 1, datë 28.02.2023 ndërsa numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 74, datë 21.12.2022, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1521/1, datë 30.12.2022.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 75, datë 21.12.2022, në zbatim të VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve të administratave të njësive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar.

Paketa fiskale për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 69, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr 1520/1, datë 09.01.2023.

Të ardhurat gjithsej për të financuar buxhetin e vitit 2023, janë planifikuar në vlerën 102,000 mijë lekë dhe në fakt janë realizuar në vlerën 64,745 mijë lekë.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Belsh si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### **c. Qëllimi i auditimit.**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, si dhe dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Belsh. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.
- mbi krijimin e të ardhurave dhe vlerësimin e mbledhjes së tyre.

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave,** rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 14 gjetje dhe ka dhënë 14 rekomandime, nga të cilat masa organizative me 10 gjetje dhe 10 rekomandime, 3 gjetje dhe 3 rekomandime të ardhura të munguara në vlerën **89,566,543 lekë** dhe 1 gjetje dhe 1 rekomandim masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.

### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

#### ***-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Debitorë 56 subjekte në vlerën 8,890,013 lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorët e biznesit.
- Debitorë familjarë 4675 familje në vlerën 80,676,530 lekë nga mosarkëtimi i taksës së tokës, taksë ndërtesë dhe tarifa vendore.
- Debitorë nga aktiviteti i tregtimit të karburanteve rezultojnë 10 subjekte në vlerën totale 7,700,000 lekë.
- Të ardhura të munguara në vlerën 1,099,220 lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për leje legalizimi nga 32 persona.
- Të ardhura të munguara në vlerën 2,184,688 lekë nga mosarkëtimi i detyrimeve për 4 subjekte lidhur me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore.

#### ***- Për pasqyrat financiare viti 2023.***

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është mbivlerësuar për vlerën 38,000 lekë, pasi në mbyllje të vitit 2023 kjo llogari është paraqitur në vlerë më të lartë në pasqyrën e pozicionit financiar, sesa ka qenë realisht.

- Vlera e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk kuadrojnë, pasi nuk kanë funksionuar duke pasur kundërparti njëra – tjetrën, por veprimet që janë ndjekur tregojnë që detyrimet në llogaritë 467 dhe 401, kanë pasur si kundërparti shpenzime në periudhën aktuale (llogaria 602 dhe 604) dhe shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria 486).

- Vlera e vendimeve gjyqësore të palikuiduara në mbyllje të vitit 2023 prej 15,252,450 lekë, nuk është kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare, duke sjellë një nënvlerësim në këtë vlerë të paraqitjes së detyrimeve të prapambetura.

- Amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” dhe 218 “Inventari ekonomik”, nuk është zbatuar saktë si rrjedhojë e mospërdorimit të normave të sakta të amortizimit, sipas llojit specifik të aktivitetit.

#### ***- Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve***

Nga 1306 prona të paluajtshme publike shtetërore (pa përfshirë ish-komunat), të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Belsh (Qendër) sipas VKM-ve përkatëse, rezultojnë të pajisura me certifikatë pronësie vetëm 14 prona, ndërsa për pronat e tjera nuk ka informacion.

Për katër ish-komunat Kajan, Grekan, Rrase dhe Fierze nuk ka Vendim të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës përfundimtare të pronave të transferuara.

Në Bashkinë Belsh inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Nga ana e Bashkisë Belsh nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

## **I.1.KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT**

### **a. Opinioni mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Belsh për periudhën ushtrimore 01.01.2023 - 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të shprehim një opinion **të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes**, e shprehur kjo në bazën për opinionin për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Belsh, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin e pa kualifikuar me theksim të çështjes”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje, të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemimin e tyre.

### **Baza për opinionin e pamodifikuar/ pakualifikuar me theksim çështje:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë

përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **18,457 mijë lekë**. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705).

### **Theksimi i çështjes:**

**1.** Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është mbivlerësuar për vlerën 38,000 lekë, pasi në mbyllje të vitit 2023 kjo llogari është paraqitur në vlerë më të lartë në pasqyrën e pozicionit financiar, sesa ka qenë realisht.

**2.** Vlera e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” dhe 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk kuadrojnë, pasi nuk kanë funksionuar duke pasur kundërparti njëra – tjetrën, por veprimet që janë ndjekur tregojnë që detyrimet në llogaritë 467 dhe 401, kanë pasur si kundërparti shpenzime në periudhën aktuale (llogaria 602 dhe 604) dhe shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria 486).

**3.** Vlera e vendimeve gjyqësore të palikuiduara në mbyllje të vitit 2023 prej 15,252,450 lekë, nuk është kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare, duke sjellë një nënvlerësim në këtë vlerë të paraqitjes së detyrimeve të prapambetura.

**4.** Amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri dhe pajisje*” dhe 218 “*Inventari ekonomik*”, nuk është zbatuar saktë si rrjedhojë e mospërdorimit të normave të sakta të amortizimit, sipas llojit specifik të aktivitetit.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 622/1 prot., datë 09.05.2024 “*Auditim Financiar në Bashkinë Belsh*”, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “*Bashkia Belsh*”, nga data 13.05.2024 deri në datë 07.06.2024, u krye “*Auditimi Financiar*” për periudhën nga data 01.01.2023 deri me 31.12.2023, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. K. P., *Përgjegjës Grupi*,
2. E. S., *anëtar*,
3. E. G., *anëtar*.

### **1.OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.**

**Objektivi dhe qëllimi i auditimit:** Objektivi i auditimit financiar, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e

raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Belsh.

**Identifikimi i çështjes:** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Belsh, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë financiare të Bashkisë Belsh.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre.

- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.

- Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Kryetari i Bashkisë, z. A. T., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A. N., Drejtor i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

**Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe



një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Belsh, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Kriteret e vlerësimit:** Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Belsh është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Belsh. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë: Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; - Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”; VKM Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar,

të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”; Udhëzimi i MF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; Udhëzimi i MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”; Udhëzimi i MF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022; UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, dt. 16.10.2017; Udhëzimi nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike; Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”; Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”; Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë; Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut; Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

**Standardet e auditimit:** Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Belsh grupi i auditimit ka ndjekur standardet si vijon: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit:** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

**Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>:** Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

**Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:**

**Kontrolli aritmetik:** Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

**Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

**Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

**Kontrolli i vlerësimeve:** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

**Konfirmimi nga të tretët:** Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

**Kontrolli sipas një treguesi:** Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normale", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

**Verifikimi i transaksioneve:** Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

**Intervistimi:** Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

---

<sup>1</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

**Raporte dhe Informacione:** Janë shqyrtuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

**Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm:** Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Dokumentimi i auditimit:** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera tërëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren janë mbajtur 4 (katër) Akt - Konstatime, dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit, brenda afatit të periudhës së auditimit, data 07.06.2024.

Pas përfundimit të auditimit dhe gjatë hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, deri në datën 21.06.2024 nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti lidhur me Akt – Konstatimet. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 622/2 prot., datë 24.06.2024. Gjatë hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, deri në datën 25.07.2024, nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti lidhur me Projekt Raportin e Auditimit, në zbatim të pikës 1 të nenit 33 të Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH, miratuar me vendim nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Belsh

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrik, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19.503 banorë dhe densitet prej 99.28 banorë për km<sup>2</sup>, ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32.389 vetë dhe densitet prej 168.88 banorë për km<sup>2</sup>. Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Belshit shtrihet pothuajse tërësisht në pllajën kodrinore karstike të Dumresë, një zonë kodrash të buta me bazë gëlqerore mbi të cilat është krijuar një panoramë piktoreske me 85 liqene karstike me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14.2 km<sup>2</sup>.

Kodrat e Dumresë qenë në përgjithësi të mbuluara me pyje dushku, por pjesa më e madhe e pyjeve u prenë gjatë kohës së komunizmit për të krijuar hapësirë për toka buke. Një pjesë e banorëve të kësaj zone janë zhvendosur në të kryesisht nga rrethi i Gramshit në periudhën e mbretit Zog, por



edhe pas çlirimit të vendit. Belshi është një bashki tërësisht rurale me produkte të diversifikuara nga blegtoaria të zarzavateve dhe bostanoret, por një numër fermerësh janë përqendruar te kultivimi i duhanit, për të cilin janë specializuar. Një pjesë e këtyre tokave, veçanërisht atyre të hapura për kultivim pas viteve 1970, kanë rendiment të ulët për shkak të mungesës së aksesit në vaditje. Rrjedhimisht në disa anë të bashkisë së re ka një tendencë për braktisje të tokës bujqësore, e cila ofron edhe një mundësi për rikthimin e pyjeve të dushkut, të cilat kanë gjithashtu leverdishmëri ekonomike, por në terma afatgjatë<sup>2</sup>.

### **Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:**

<b>Emri i Njësitë</b>	<b>Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre</b>
Belsh	Fshatrat; Belsh Qëndër, Çepe, Dushk, Belsh, Stanaj, Shkozë, Qafë Shkallë, Seferan, Trojas, Shkëndi, Gradisht, Marinëz, Shtith
Grekan	Fshatrat; Grekan, Dëshiran, Guras, Rrenës
Kajan	Fshatrat; Kajan, Dragot, Lisaj, Dragot-Dumre, Gjinuk, Gjolen, Turbull, Çestije, Merhoj, Drizaj
Fierzë	Fshatrat; Fierzë, Hardhi, Çerragë, Kosovë
Rrasë	Fshatrat; Rrasë e Sipërme, Shegas, Guri i Bardhë, Rrasë e Poshtme

### **Forma dhe mënyra e organizimit:**

Numri i përgjithshëm i punonjësve është bazuar në VKB nr. 75 datë 21.12.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1514/1 datë 30.12.2022. Struktura Organizative është miratuar me Urdhrin Nr. 1, datë 28.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Bashkia Belsh për vitin 2023 ka pasur në strukturë 228 punonjës.

### **Kuadri ligjor:**

Bashkia Belsh është e organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Belsh, akte të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Belsh dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

## **2. Përshkrimi i rezultateve, sipas drejtimeve të auditimit**

### **Pika 2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

#### **Programimi i PBA 2023 - 2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.**

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023 - 2025 rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr.20, datë 10.03.2023, të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 18, datë 24.03.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 406/1 datë 03.04.2023.

Projektbuxheti Afatmesëm për vitet 2023-2025 është miratuar përkatësisht me VKB nr.29, datë 08.04.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 503/1, datë 14.04.2022 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr.2048, datë 20.07.2022.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 16 (gjashtembëdhjetë) programe buxhetore. Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA në 000/lekë.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	1110 (Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi)	93,131	24%	95,760	11.6%	97,700	24%

<sup>2</sup> Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-belsh/pasaporta-e-bashkise/>

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
2	3140 (Cështjet financiare dhe fiskale)						
3	3280 (Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile)	13,866	4%	13,866	2.3%	13,866	3%
4	4220 (Shërbimet bujqesore)						
5	4240 (Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit)	12,563	3%	12,603	1.5%	12,685	3%
6	4260 (Administrimi i pyjeve dhe kullotave)	2,131	1%	2,155	0.3%	2,204	0.5%
7	4520 (Rrjeti rrugor rural)	38,490	10%	40,811	5.2%	43,731	10%
8	5100 (Menaxhimi i mbetjeve)	21,254	5%	21,623	3.3%	21,999	5.4%
9	6140 (Planifikimi urban vendor)	33,632	9%	34,305	48.8%	35,634	8.7%
10	6260 (Shërbimet publike vendore)	40,290	10%	41,387	6.8%	42,214	10.3%
11	8130 (Sport dhe arëtim)						
12	8220 (Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore)	7,854	2%	8,059	1.35%	8,220	2%
13	9120 (Arsimi bazë përfshir arsimin parashkollor)	32,613	8%	32,684	4%	32,794	8%
14	9230 (Arsimi i mesëm i përgjithshëm)	2,508	1%	2,532	0.74%	2,521	0.6%
15	10430 (Kujdesi social për familjet dhe fëmijet)	85,193	22%	86,911	12%	88,649	22%
16	09180 (Fondi rezervë dhe emergjencë)	6,120	2%	6,242	2%	6,367	1.5%
<b>TOTALI</b>		<b>389,645</b>	<b>100%</b>	<b>398,939</b>	<b>100%</b>	<b>408,584</b>	<b>100%</b>

Ndërsa ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga 600	129,332	33%	132,018	33%	132,189	32%
2	Sig. 601	32,333	8%	33,004	8.3%	35,139	9%
3	Shpenzime operative 602	59,600	15%	63,220	15.8%	66,127	16%
4	Shpenzime .....604	1,000	0.4%	1,000	0.3%	1,000	0.5%
5	Shpenzime .....606	99,127	25%	98,358	24.6%	98,358	24%
6	Fondirezervdhekontigjences 609	6,120	1.6%	6,242	1.6%	6,367	1.5%
7	Investime 230-231	62,133	16%	65,097	16.3%	69,405	17%
<b>Total</b>		<b>389,645</b>	<b>100%</b>	<b>398,939</b>	<b>100%</b>	<b>408,584</b>	<b>100%</b>

Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

A	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	102,997	103,952	104,617
2	Jo tatimore	404	407	409
<b>I</b>	<b>Totali</b>	<b>103,401</b>	<b>104,359</b>	<b>105,026</b>
1	Transferta e pakushtëzuar	219,274	227,610	236,588
2	Transfertespecificke	66,970	66,970	66,970
<b>II</b>	<b>Shuma e transfertave</b>	<b>286,244</b>	<b>294,580</b>	<b>303,558</b>
<b>III</b>	<b>Transferta te pritshme (FZHR e tjera)</b>			-
<b>Totali i burimeve të veta (I +II+III)</b>		<b>389,645</b>	<b>398,939</b>	<b>408,584</b>

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me VKB nr. 70, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1510/1 prot., datë 30.12.2023 si dhe VKB nr. 2, datë 24.01.2023 "Për miratimi i të ardhurat e trashëguara dhe grandit i trashëguar nga viti 2022". Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Belsh, për vitin 2023 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
	<b>Të ardhurat</b>	<b>442,101</b>	
	Të ardhura te veta	102,000	

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
	Grandi	216,564	
	Te ardhura te trashëguara 2022	22,651	
	Grandi i trashëguar nga viti 2022	29,392	
	<b>Shpenzimet</b>		<b>412,274</b>
	Paga (600)		132,034
	Sigurime (601)		22,298
	Shpenzime operative (602)		62,935
	Transferta (603+604+605+606+609)		12,702
	Investime (230+231) nga buxheti i bashkise		182,305
	<b>Totali i buxhetit</b>	<b>442,101</b>	<b>412,274</b>

Ndryshimi në rritje të vlerës buxhetit të vitit 2023 nga plani i buxhetit të vitit 2023 në PBA vjen si pasojë e të ardhurave dhe grantit të trashëguar nga viti 2022, në vlerën 93,711 mijë lekë dhe nga transferata e pakushtëzuar e cila për vitin 2023 është rritur në vlerën 13,840 mijë lekë.

Për sa i përket shpenzimeve rezultojnë se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime zënë 38 % ose në vlerën 162,137 mijë lekë, shpenzimet korrente zënë 24.6 % ose për vlerën 105,708 mijë lekë, transferata zënë 2% ose për vlerën 8,435 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 35.4 % ose në vlerën 153,841 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar me Urdhrin e kryetarit të Bashkisë nr. 1, datë 28.02.2023 ndërsa numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 74, datë 21.12.2022, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1521/1, datë 30.12.2022.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 75, datë 21.12.2022, në zbatim të VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve të administratave të njësisve të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar.

Paketa fiskale për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 69, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr 1520/1, datë 09.01.2023.

**Të ardhurat gjithsej për të financuar buxhetin e vitit 2023, janë planifikuar në vlerën 102,000 mijë lekë dhe në fakt janë realizuar në vlerën 64,745 mijë lekë.**

Të analizuara shpenzimet e miratuara në buxhetin e vitit 2023, për **shpenzimet operative (602) janë planifikuar në vlerën 105,122 mijë lekë**, si më poshtë:

- (6020) Blerje kancelarie, pastrimi, elektrike dhe blerje materiale të ndryshme, në vlerën 10,000 mijë lekë,
- (6022) Shërbime të ndryshme si: energji, ujë, shërbim telefonik, shërbim postar, shërbim pastrimi, dru zjarri për ngrohjen e shkollave, në vlerën 31,000 mijë lekë,
- (6023) Shërbime transporti si: gazoil, pjesë këmbimi dhe siguracion mjete, në vlerën 7,700 mijë lekë.
- (6025) Mirëmbajtje godinash, mirëmbajtje kanale kulluese dhe vaditëse, shërbime për mirëmbajtje të rrugëve, mirëmbajtje të shesheve dhe lulishteve, shërbime mirëmbajtje të ambienteve të shkollave (lyerje), në vlerën 40,630 mijë lekë.
- (6027) Vendime përmbarimore dhe gjyqësore, në vlerën 7,000 mijë lekë,
- (6029) Shpërblime të Këshillit Bashkiak dhe kryepleq të fshatrave, në vlerën 4,000 mijë lekë.
- Projekt social për gratë e papuna në vlerën 4,792 mijë lekë.

**Planifikimi i shpenzimeve kapitale (230+231), në vlerën 153,841 mijë lekë**, për objektet si më poshtë:

- Objekti “Klasa Smart Lab 400 mijë lekë,
- Objekti “Pajisje Kompiuterike 300 mijë lekë,



- Objekti Kolaudim Punimesh Rik. Ambienteve Bashkisë Belsh (2016) 38 mijë lekë.
- Kolaudim Punimesh "Rikon. i qendrës shëndetësore Belsh, në funksion të zyrave të Bashkisë Belsh" 9 mijë lekë.
- Blerje lëndë inerte për rehabilitimin e disa rrugëve të fshatrave të Bashkisë Belsh 2,480 mijë lekë.
- Blerje lëndë inerte për rehabilitimin e disa rrugëve të fshatrave të Bashkisë Belsh 200 mijë lekë.
- Kolaudim Punimesh Sistemim Asfaltim Rruga Trojas (Unaza Belsh) 120 mijë lekë.
- Shpronësime për Objektin Ndërtim, sistemim, asfaltim rruga Trojas (unaza Belsh) 2017 1,500 mijë lekë.
- Kolaudim punimesh objekti "Sistemim, Asfaltim rrugëve të brendëshme Bashkisë Belsh 165 mijë lekë.
- Projekti i Azhornimi i Tokave Bujqësore të fshatit Kosovë Njësia ADM Fierze 3,000 mijë lekë
- Mbikëqyrje punimesh "Rikon. Asfaltim Rrugës Belsh - Shkendi" 120 mijë lekë.
- Mbikëqyrje Punimesh Skema Ujitjes e Fushës Cestie (Degëzimi Kosovë) Pjesshëm 80 mijë lekë.
- Kolaudim Punimesh Skema Ujitjes e Fushës Cestie (Degëzimi Kosovë) Pjesshëm 50 mije leke
- Mbikëqyrje Punimesh objekti "Përmirësimi i kushteve të Banimit Komunitet Pafavorizuar" 2018 120 mijë lekë.
- "Mbikëqyrje Punimesh objekti "Përmirësimi i kushteve të Banimit Komunitet Pafavorizuar" 2021 480 mijë lekë.
- Mbikëqyrje punimesh "Ndërtim i rrjetit elektrik për magazinën bujqësore Belsh" 60 mijë lekë.
- Kolaudim punimesh "Ndërtim i rrjetit elektrik për magazinën bujqësore Belsh" 30 mijë lekë.
- Mbikëqyrje punimesh "Ndërtim i murit rrethues/sigurues në vendin e ndërtimit të magazinës bujqësore Belsh" 100 mijë lekë.
- Kolaudim Punimesh "Ndërtim i murit rrethues/sigurues në vendin e ndërtimit të magazinës bujqësore Belsh" 60 mijë lekë.
- Mbikëqyrje punimesh rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Qendrës Spitalore Belsh 66 mijë lekë
- Hartim Projekti "Ndërtimi i ambienteve për zyra të Bashkisë Belsh" 2,000 mijë lekë
- Pemë dekorative për Gjelbërim 2023 1,600 mijë lekë
- Mbikëqyrje punimesh "ngritja e fermës organike 44Ha me bimë medicinale 262 mijë lekë
- Tabela për sinjalistikën Rrugore 2,547 mijë lekë.
- Sistemim dhe Asfaltim i rrugës Belsh – Stanaj 29,154 mijë lekë
- Mbikëqyrje punimesh "Sitemim dhe asfaltim I rrugës Belsh Stanaj" 696 mijë lekë
- Kolaudim punimesh objekti "Rikonstruksion i banesave të familjve në nevojë" 3 mijë lekë.
- Hartim projekti për ndërtimin e ujërave të zeza të Belsh Qënder, Trojas, Hyse dhe mbrojtjen e liqenit 598 mijë lekë.
- Rikonstruksioni i rrugës "Rrasë – Hysgjokaj, Pajallinj, Beqiraj, Gradishte 22,937 mijë lekë.
- Fond MFE për pagesë TVSH të projekteve me financim të huaj 202 mijë lekë.

Emërtimi	Viti 2023			
	Plani	Fakti	Status	Kontratë
Aparati baskisë	140	140	43	17
Njësia Adminin	15	15		0
Njësi vartëse	70	70		0
Tjera	-	-	-	-

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.



Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, investime, ndihma ekonomike, gjendja civile, grande, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit prej 412,274 mijë leke, për vitin 2023 buxheti shtesë gjithsej është në vlerën **1,311,243 mijë lekë**, e analizuar si më poshtë:

1. Transfertë e kushtëzuar për investime, në vlerën 583,536 mijë lekë, për objektet sipas pasqyrës aneks nr. 2/5, bashkëlidhur.
2. Transfertë e kushtëzuar për Ndihmën ekonomike dhe PAK, në vlerën 279,805 mijë lekë
3. Transfertë e kushtëzuar për Gjendje Civile, në vlerën 4,285 mijë lekë
4. Transfertë e kushtëzuar për emergjenca, në vlerën 11,582 mijë lekë
5. Transfertë e kushtëzuar për shërbimet ne zgjedhjet vendore, në vlerën 1,915 mijë lekë
6. Transferte e pakushtëzuar për të përballuar rritjen e pagave dhe për detyrime të prapambetura, në vlerën 17,846 mijë lekë sipas VKB nr.50, datë 22.08.2023.

*Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.*

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e Këshillit Bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2023 referuar aktrakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/ lekë*

Nr.	Emertimi	Viti 2023							
		Plani fillim Viti 2023	plani në Thesar sipas akt rakordimit	Fakti mesipas aktrakordimit sipas Thesarit	Te ardh. veta	Grant	Trans. Pakushtez. Spec. Funk Deleg	Tran. Kusht.	Tra. Kush Per Inv.
1	Paga (600)	117,434	147,130	143,928	40,000	39,540	60,000	4,388	0
2	Sigurime (601)	22,298	23,889	23,622	6,680	6,210	10,020	712	0
3	Shpenzime (602)	77,035	118,320	71,544	17,268	41,023	13,148	105	0
4	(604) F. Re+emer	12,100	3,900	0	0	0	0	0	0
5	Fondi Veçantë (606)	400	8,121	8,545	1,129	7,416	0	0	0
6	Fond Ne+Pak (606)	0	276,776	257,159	0	1,234	0	255,925	
7	Inv (230 +231)	183,008	725,425	634,513	6,198	44,779	0	0	583,536
8	Transferta 604		7,682	6,266	2,991	0	0	3275	
<b>Totali</b>		<b>412,274</b>	<b>1,311,243</b>	<b>1,145,577</b>	<b>74,267</b>	<b>140,202</b>	<b>83,168</b>	<b>264,404</b>	<b>583,536</b>

Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2023, nga 1,311,243 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,145,577 mijë lekë ose në masën 87.3 %, sipas burimit të financimit e buxheti në fakt është financiar si më poshtë:

Nga të ardhurat e veta në masën 6.4% ose në vlerën 74,267 mijë lekë,

Nga granti në masën 12.5% ose në vlerën 140,202 mijë lekë,

Nga transfertat e pakushtëzuar specifike në masën 7.2% ose në vlerën 83,168 mijë lekë,

Nga transfertat e kushtëzuar 23% ose në vlerën 264,404 mijë lekë,

Nga transfertat e deleguar për investime 50.9% ose në vlerën 583,536 mijë lekë, sipas artikujve të shpenzimeve treguesit e buxhetit në tërësi dhe sipas burimeve të financimit janë realizuar si më poshtë:

-Pagat (600) nga 147,130 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 143,928 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura të veta në vlerën 40,000 mijë lekë, grant në vlerën 39,540 mijë lekë, transfertë e pakushtëzuar specifike në vlerën 60,000 mijë lekë dhe transfertë e kushtëzuar në vlerën 4,388 mijë lekë) ose 97.8%,

-Sigurime shoq. (601) nga 23,889 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 23,622 mijë lekë, me burim financimi (të ardhurat të veta në vlerën 6,680 mijë lekë, grant në vlerën 6,210 mijë lekë, transfertë e pakushtëzuar specifike në vlerën 10,020 mijë lekë dhe transfertë e kushtëzuar në vlerën 105 mijë lekë) ose 98.8%,

-Shpenzime operative (602) nga 118,320 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 71,544 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura të veta në vlerën 17,268 mijë lekë, grant në vlerën 41,023 mijë lekë, transfertë e pakushtëzuar specifike në vlerën 13,148 mijë lekë dhe transfert e pakushtëzuar në vlerën 105 mijë lekë) ose 60.4%, më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi.

-Shpenzime për ndihma nga transfertat dhe fond rezervë (604-609) nga 19,703 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 14,811 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura të veta në vlerën 4,120 mijë lekë, grant në vlerën 8,650 mijë lekë) ose 75%.

- Shpenzime për investime (230 - 231) nga 725,425 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 634,513 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura të veta në vlerën 6,198 mijë lekë, grant në vlerën 44,779 mijë lekë dhe transfertë e kushtëzuar në vlerën 583,536 mijë lekë) ose 87.5%, më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi.

Përsa i përket likuidimit të shpenzimeve operative, sipas urdhër shpenzimeve rezulton se me buxhetin e vitit 2023 janë likuiduar fatura për mallra e shërbime të vitit 2022, në vlerën 2,878,499 lekë dhe shpenzime të vitit në vlerën 60,852,209 lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

Përsa i përket likuidimit të shpenzimeve për investime, sipas urdhër shpenzimeve rezulton se me buxhetin e vitit 2023 janë likuiduar shpenzime për investime të vitit 2022, në vlerën 371,567,236.8 lekë dhe investime të vitit në vlerën 259,349,733.2 lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2023, janë dërguar në MFE me shkresat nr. 1381, datë 23.05.2023 “Mbi raportin e monitorimit për 4-mujorin e parë” dhe shkresa nr. 515, datë 05.02.2024 “Mbi raportin e monitorimit për 12-mujorin e vitit 2023”, brenda afateve ligjore.

Nr	Emertimi	Plani	%	Fakti	%	% e realizimit
1	Paga (600)	147,130	11.2%	143,928	12.5%	97.8%
2	Sigurime (601)	23,889	1.8%	23,622	2%	98.9%
3	Shpenzime (602)	118,320	9%	71,544	6.5%	60.5%
4	(604) F. Rezervë	11,582	0.8%	6,266	0.5%	54.1%
5	Transferta 606	284,897	21.7%	265,704	23.2%	93.3%
6	Inv (230 +231)	725,425	55.5%	634,513	55.3%	87.5%
	<b>Totali</b>	<b>1,311,243</b>	<b>100%</b>	<b>1,145,577</b>	<b>100%</b>	

**Konstatimi:** Realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për vitin 2023, nga 1,311,243 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,145,577 mijë lekë ose në masën 87.3 %. Pagat (600) nga 147,130 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 143,928 mijë lekë, ose 97.8%, Sigurime shoq. (601) nga 23,889 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 23,622 mijë lekë ose 98.8%, Shpenzime operative (602) nga 118,320 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 71,544 mijë lekë, ose 60.4%, Shpenzime për ndihma nga transfertat dhe fond rezervë (604-609) nga 19,703 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 14,811 mijë lekë ose 75%; dhe Shpenzime për

investime (230-231) nga 725,425 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 634,513 mijë lekë ose 87.5%, konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative dhe investime, të cilat janë zërat më kryesorë të buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky fakt vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore që nga 102,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 64,745 mijë lekë ose 60%, veprim jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali I shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>			
<b>a</b>	<b>Hua sftatgjatë</b>			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>			
<b>a</b>	<b>Shpenzimekorrente</b>			
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
<b>b</b>	<b>Shenzimekapitale</b>			
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	20,045,380		
<b>c</b>	<b>Vendimegjyqësore</b>	15,252,450		
c,1	Marrëdhënie pune			
			351,533,304	10.04%

c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime	94,625,435		
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>35,297,830</b>	<b>351,533,304</b>	<b>10.04%</b>

Sa më sipër rezulton se totali i detyrimeve të palikuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 35,297 mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 351,533 mijë lekë zënë 10%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 515 prot., datë 05.02.2024.

Nga të dhënat e bilancit rezulton se detyrimi i faturave të pa likuiduara dhe vendime gjykate në fund të vitit 2023, ka detyrime të panjohura që i përkasin llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” janë për vlerën 126,223,897 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” janë për vlerën 518,075 lekë, gjithsej në vlerën 126,741,972 lekë sipas të dhënave të pasqyrave si më poshtë:

Nr.	Përfituesi	Përmbartuesi	Shuma e përfitimit	Arsyeja	Shuma e likuiduar nga Ministria	Shuma e mbetur
1	S. T.	F. A.	14,123,657.0	Shpronesim prone	9,440,995.0	4,682,662.0
2	C. T.	I. E.	10,569,788.0	Shpronesim prone	0.0	10,569,788.0
<b>Totali</b>			<b>24,693,445.0</b>			<b>15,252,450.0</b>

- Dokumentacioni mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes Ministrisë, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Belsh ka përfituruar fonde nga Ministrinë në vlerën 856,833 lekë nga të cilat janë likuiduar gjatë vitit në vlerën 794,538 lekë.

Emri i Furnitorit	Emri i kontratës	Shuma e faturës
F. Sh.p.k	Permiresimi i kushteve te banimit	83,493
F. Sh.p.k	Permiresimi i kushteve te banimit	1,005,437
F. Sh.p.k	Permiresimi i kushteve te banimit	146,160
P. P. Sh.p.k	Performance dhe realizimi i veprave te artit liqeni belsh	4,800,000
P. P. Sh.p.k	Performance dhe realizimi i veprave te artit liqeni belsh	3,600,000
E. sh.p.k	Situacion nr.14 Furnizim me uje te pijshem i zones se Dumrese,Faza III	28,384,697
E. sh.p.k	Situacion nr.15 Furnizim me uje te pijshem i zones se Dumrese,Faza III	56,605,648
<b>Shuma e Objekteve te investimit parashikuar me fondet e Qeverise</b>		<b>94,625,435</b>
B. sh.p.k	Rikonstruksion dhe asfaltim rruga kryesore qyteti belsh	5,577,736
V. H. Shpk	Projektim i asambllit rilindja	14,176,193
A. MK	Kolaudim Punimesh Shkolla Seferan	108,000
A. M.	Situacioni per projektin e rrjetit ABC per magazinën bujqesore	47,451
L. K.	Kolaudim punimesh	36,000
K. B.	Mbikeqyrje punimesh rikualifikimi urban i fasadave	100,000
<b>Shuma e Objekteve te investimit parashikuar me fondet e Bashkise</b>		<b>20,045,380</b>
<b>TOTALI</b>		<b>114,670,815</b>

**Konstatim:** Nga auditimi ka rezultuar se totali i detyrimeve të palikuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 35,297 mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 351,533 mijë lekë zënë 10%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 515 prot., datë 05.02.2024. Nga të dhënat e bilancit rezulton se detyrimi i faturave të pa likuiduara dhe vendime gjykate në fund të vitit 2023, që i përkasin llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” janë për vlerën 126,223,897 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” janë për vlerën 518,075 lekë, gjithsej në vlerën 126,741,972

lekë. Detyrimet e papapaguara gjithsej në vlerën 35,297 mijë lekë nga mungesa e fondeve kryesisht nga të ardhurat veta të cilat për vitin 2023 nuk janë realizuar në vlerën 45,525 mijë lekë vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91.

*Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues të institucionit, z. A. N.*

**Nënpika 2.1.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave, qiratë e aseteve, tokave, pyje kullotave etj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

Për realizimin e pikës së programit, grupi i auditimit shfrytëzoi këto dokumente të paraqitura nga subjekti audituar Bashkia Belsh, si vijon:

- Evidencat e realizimit të planit të vitit 2023.
- Rakordimet me agjentët e mbledhjes së të ardhurave për vitit 2023.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.
- Evidencat për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.
- Të tjera dokumente mbështetëse.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:**

Për vitin 2023 në Bashkinë Belsh ka funksionuar Sektori i të Ardhurave Vendore miratuar me VKB nr. 69, datë 21.12.2022 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për vitin 2023” e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë nr. 1520/1, datë 09.01.2023, me 9 punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës dhe 8 Specialistë.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji Biznesit	Viti 2023			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	379	10	18	371
B. Madh	54	5	2	57
<b>TOTALI</b>	<b>433</b>	<b>15</b>	<b>20</b>	<b>428</b>

Sipas të dhënave të tabelës, konstatohet se në fund të vitit 2023 gjendja e subjekteve fizik/juridik është për 428 subjekte (371 subjekte të biznesit të vogël, 57 subjekte të biznesit të madh), ku gjatë këtij viti ushtrimor janë mbyllur 20 subjekte dhe hapur të reja 15 subjekte, pra 5 subjekte mbyllur më shumë se hapur.

Paketa fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me Vendim të KB nr. 69 datë 21.12.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Belsh 2022”, ku sipas saj janë planifikuar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023. Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore paraqiten në tabelën 1.

**Tabela 1: Realizimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, viti 2023 (në 000 lekë)**

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2022			Viti 2023		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3	4	5	6
<b>I</b>	<b>Te ardhura nga Tatimet</b>	-	-		<b>120</b>	<b>195</b>	
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	-	-		120	195	162
<b>II</b>	<b>Te ardhura nga Taksat</b>	<b>74,830</b>	<b>42,877</b>		<b>71,470</b>	<b>37,178</b>	
2	Taksa mbi B. Vogël	20	22	111	20	118	593
3	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	17,500	15,655	89	17,500	8,945	51
4	Taksa mbi token Bujqësore	42,500	13,392	32	40,500	14,762	36
5	Takse mbi regji e Automjete	6,700	7,168	107	7,000	7,736	110
6	Taksa e ndik te ndmbi infrast	4,000	2,969	74	2,500	1,699	68
7	Takse Tabele	300	171	57	230	238	103
8	Takse trualli	250	224	90	220	180	82
9	Takse vendore për ujin	150	134	89	150	140	93
10	Takse për hapësira publike	3,400	3,138	92	3,350	3,354	100
11	Takse vendore e përkohshme	10	-	0	-	-	-
<b>III</b>	<b>Te ardhura nga Tarifaf</b>	<b>24,815</b>	<b>22,424</b>		<b>28,320</b>	<b>7,288</b>	
12	Tarife Pastrimi	15,100	13,789	91	15,110	9,171	60
13	Tarifë për autorizim urbanistik	400	85	21	100	155	155
14	Tarife leje transport.	290	436	150	130	319	246
15	Tarife gjelbërimi	340	350	103	340	306	90
16	Tarife për përdorim certifikate	250	205	82	200	192	96
17	Tarife vërtetimi	105	84	81	100	46	46
18	Tarife leje zhvillimi	100	70	70	100	50	50
19	Tarifë regji biznes i Ri	-	-	0	10	2	20
20	Tarife ndriçimi rrugor	2,830	2,042	72	2,830	1,240	43
21	Te ardhura te tjera	2,900	3,621	125	3,400	4,236	124
22	Tarife për leje ndërtimi	2,500	1,739	70	6,000	1,566	42
<b>IV</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>2,355</b>	<b>2,148</b>		<b>2,090</b>	<b>1,812</b>	
23	Qira trualli	-	-		-	-	0
24	Shitje Pase&privatiz banese	-	-		-	-	0
25	Qira trojesh	800	921	115	1,000	759	75
26	Te ardhura nga miratim projekti MNZSH	-	-		40	-	0
27	Te ardhura nga shërbimi MNZSH	-	-		20	60	300
28	Gjoba.	100	288	288	250	11	4
29	Takse Vule	-	-		-	-	0
30	Qira ndërtesë	200	202	101	220	165	75
31	Kamatëvonesë	455	424	93	310	722	233
32	Te ardhura te tjera jo tatimore	800	312	39	250	93	37
	<b>GJITHSEJ ( I+II+III+ IV)</b>	<b>102,000</b>	<b>67,451</b>	<b>66%</b>	<b>102,000</b>	<b>56,475</b>	<b>55%</b>

Nga të dhënat rezultojnë se, për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifaf vendore, nga vlera 102,000 mijë lekë të parashikuara, është realizuar në vlerën 56,475 mijë lekë ose 55 %, *me një mosrealizim në vlerën 45,525 mijë lekë*, nga të cilat: të ardhura nga taksat nga vlera 71,470 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 37,178 mijë lekë ose 52%, të ardhura tarifaf nga vlera 28,320 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 7,288 mijë lekë ose 25 % dhe të ardhura të tjera nga vlera 2,090 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 1,812 mijë lekë ose 86.6 %.

Nga të dhënat e tabelës nga 32 zëra fiskal, janë me realizim 9 zëra dhe me mos realizim janë 23 zëra. Mos realizimet vijnë nga 42% (tarifë për leje ndërtimi, etj), deri në 96% tarifë përdorimi certifikatë. Mos realizimi i të ardhurave vjen si rezultat i punës jo efektive të administratës së të ardhurave dhe mos planifikimi të saktë të të ardhurave në raport me mundësitë ekonomike që ka kjo njësi vendore.

Gjithashtu, konstatohet se megjithëse parashikimi është i pandryshuar nga njëra periudhë në tjetër, fakti ka një rënë nga viti 2022. Kështu arkëtimet e vitit 2022 kanë qenë në vlerën 67,450 mijë lekë, ndërsa në vitin 2023 ato janë në vlerën 56,475 mijë lekë, pra me një diferencë 10,975 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, nenet 4 dhe 5, si dhe VKB nr.78 datë 15.11.2021“Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2022”.



Në lidhje me menaxhimin e taksave/tarifave të abonentëve familjarë, konstatohet se nuk ka një regjistrë për sipërfaqen e tokës së ndarë për çdo familje dhe sipërfaqet e ndërtesave të banimit, kështu që planifikimi i tyre është bërë sipas realizimit të një viti më parë dhe jo mbi bazën e të dhënave që Sektori i të Ardhurave Vendore duhet të merrte nga regjistri elektronik i ASHK, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin taksave vendore” i ndryshuar neni 22, pika 1, ku përcaktohet se... Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi, neni 23, pika 1, ku përcaktohet se ... Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Tatimi mbi biznesin e vogël, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit.

Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia. Taksa e rentës është planifikuar sipas realizimit të vitit të mëparshëm po kështu dhe TAP është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë, të cilat për vitin 2023 rezultojnë me tejkalim.

Pra planifikimet janë kryer pa pasur të dhëna mbi bazën e të cilave bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 117 dhe UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

### **Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore në vlerën gjithsej **89,566,543 lekë**, nga të cilët: *56 subjekte të biznesit të vogël/ dhe të madh në vlerën 8,890,013 lekë, taksa e tarifa nga abonentët familjarë për 1452 abonentë me vlerë 5,737,120 lekë dhe taksa e tokës bujqësore për 3223 subjekte me vlerë 74,939,410 lekë*, që disponojnë Nj/Administrative të Bashkisë, në mënyrë të përmbledhur pasqyra e debitorëve si më poshtë:

EMËRTIMI	31.12.2022		31.12.2023	
	Vlera	Nr. Subjekte e familje	Vlera	Nr. Subjekte e familje
<b>Debitorë ne total</b>	<b>84,755,055</b>	<b>4460</b>	<b>89,566,543</b>	<b>4731</b>
Biznesi i madh/vogël	9,448,862	160	8,890,013	56
Familje për taksa tarifa	5,359,512	1452	5,737,120	1452
Familje për taksë toke	69,946,681	2848	74,939,410	3223

**Konstatimi:** Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se debitorët nga taksat e tarifat vendore më 31.12.2023 janë në vlerën **89,566,543 lekë**, nga e cila: *njihet si detyrim nga bashkia vlera 55,524,044 lekë, e cila rezulton e raportuar në pasqyrat financiare dhe nuk është evidentuar (kontabilizuar), diferenca prej 34,041,499 lekë, si ardhur e munguar.*

Në totalin e debitorëve, peshën kryesore e zë taksa e tokës bujqësore me 84% të totalit.

Në krahasim me vitin 2022, debitorët kanë pësuar rritje në vitin 2023 për vlerën 4,811,488 lekë.

Nga Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është ndjekur e plotë procedura për mbledhjes me forcë të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga bashkia (Sektori i të Ardhurave Vendore ), për vitin 2023 është kërkuar në zbatim të ligjit vetëm bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, për 69 subjekte me vlerë 6,491,151 lekë ose 4% e totalit të detyrimeve që kjo bashkia, duke mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër në zbatim të dispozitave ligjore.

**- Dinamika e debitorëve:**

- a- Debitorë nga 1 deri në 3 vite nr.55, vlera 1,836,244 lekë;
- b- Debitorë nga 3 deri në 5 vite nr. 10 , vlera 979,084 lekë;
- c- Debitorë mbi 5 vite nr. 9, vlera 1,441,868 lekë;
- d- Debitorë pa shpresë arkëtimi nr. 6, vlerë 1,629,977 lekë;
- e- Debitorë me status pasiv/mbyllje nr. 33, vlera 3,002,840 lekë.

Gjithashtu, nga të dhënat konstatohet se nga Sektori i të Ardhurave Vendore është lejuar të mbyllë ose kalojë në status pasiv **33** subjekte me vlerë debitorë prej 3,002,840 lekë, kjo tregon mos bashkëpunimin ndërmjet institucioneve (QKB/DAV Bashkia Belsh).

Nuk dokumentohet momenti i protokollim të mbylljes së regjistrit elektronik vjetor ekzistues dhe krijimit të regjistrit elektronik të ri vjetor, të dhëna të cilat do shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksat/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitorë, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitorë në bankat e nivelit të dytë apo QKB) realizimi në drejtimin e Bashkisë Belsh dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit. Nga auditimi për taksën e lëshimit të Autorizimeve/ Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Belsh për periudhën e vitit 2023 nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përsa i përket arkëtimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh.

Referuar kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar. Sipas të dhënave nga Sektori i të Ardhurave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Belsh, rezulton se **18** subjekte për shitjen karburanteve, si më poshtë:

*Tabela. Subjektet e tregtimit të karburanteve në territorin e Bashkisë Belsh*

Nr. Liçencës	Emërtimi i Subjektit	Data e fillimit të Autorizimit	Data e mbarimit të Autorizimit	Shuma për t’u paguar	Pagesa e kryer me këste	Detyrim i mbetur
1	M. V. SHPK	04.03.2019	03.03.2024	1,000,000	400,000	600,000
2	M. M. O. SHPK	27.04.2020	26.04.2025	1,000,000	1,000,000	0
3	P. SHPK	18.12.2019	19.12.2024	1,000,000	1,000,000	0
4	H. SHPK	01.07.2020	30.06.2025	1,000,000	400 000	600,000
5	K. O. SHPK	29.08.2019	28.08.2024	1,000,000	1,000,000	0
6	M. F. O. SHPK	13.12.2022	12.12.2027	1,000,000	1,000,000	0
7	<b>F. O. SHPK</b>	<b>11.10.2019</b>	<b>10.10.2021</b>	<b>1,000,000</b>	<b>400,000</b>	<b>600,000</b>
8	V. F.	05.02.2020	04.02.2025	1,000,000	1,000,000	0
9	R. SHPK	03.02.2020	02.02.2025	1,000,000	1,000,000	0
10	K. O. SHPK	27.08.2019	26.08.2024	1,000,000	1,000,000	0
11	M. SHPK	11.10.2021	10.10.2024	1,000,000	600,000	400,000



Nr. Liçencës	Emërtimi i Subjektit	Data e fillimit të Autorizimit	Data e mbarimit të Autorizimit	Shuma për t'u paguar	Pagesa e kryer me këste	Detyrim i mbetur
12	M. O.SHPK	26.03.2019	25.03.2024	1,000,000	400,000	600,000
13	Z. SHPK			1,000,000	0	1,000,000
14	D. O. 20... SHPK			1,000,000	0	1,000,000
15	G. O. SHPK	20.02.2014	09.02.2019	1,000,000	0	1,000,000
16	D. O. SHPK	01.06.2010	31.05.2020	1,000,000	0	1,000,000
17	Z. B. SHPK	24.12.2021	27.08.2025	1,000,000	100,000	900,000
18	G. O. SHPK	30.06.2022	29.06.2027	1,000,000	1,000,000	0
	<b>TOTALI</b>			<b>18,000,000</b>	<b>10,300,000</b>	<b>7,700,000</b>

**Konstatimi:** Nga auditimi mbi taksimin e subjekteve që tregtojnë karburante për taksën e autorizimit nga bashkia, rezulton se ushtrojnë aktivitet 18 subjekte për detyrimin prej 18,000,000 lekë. Nga kjo vlerë është bërë e mundur të likuidohet nga subjektet vlera 10,300,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera **7,700,000 lekë për 10 subjekte**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.

Konstatohet se 5 subjekte ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me autorizim ose pa rifreskuar autorizimin, të cilët nuk kanë mundur të likuidimin e detyrimit të ngarkuar në autorizimet e kaluara për vlerën 4,600 lekë.

Nga Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është ndërmarrë asnjë masë për pajisjen e tyre me licencë me qëllim arkëtimin e detyrimeve, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9 dhe VKB për miratimin e paketës Fiskale, për vitin 2023.

### **Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi dhe lejet legalizimit.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Dega Rajonale ASHK Elbasan janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **32 persona** me vlerë **1,099,220 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Belsh. Nga Drejtoria e Urbanistikës, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c., të dhënat sipas pasqyrës tabelës 2:

**Tabela 2:** *Të dhëna mbi subjektet me taksë ALUIZNI-t*

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Sipërfaqja	Vlera e detyrimit
1	G. R. S.	187.1	30,249
2	T. E. K.	210.9	34,097
3	E. B. Z.	380.8	61,565
4	B. Y. A.	436.2	70,522

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Sipërfaqja	Vlera e detyrimit
5	A. H. Sh.	315.5	51,008
6	H. L. H.	180.9	29,247
7	K. K. Z.	30.7	4,963
8	D. N. H.	106.6	17,234
9	B. Sh. K.	97	15,682
10	B. I. T.	319.2	51,606
11	M. B. T.	282.3	45,640
12	E. B. T.	247	39,933
13	Xh. A. K.	127.8	20,662
14	S. R. P.	138.7	22,424
15	A. N. E.	257.4	41,615
16	N. F. Sh.	82.5	13,338
17	A. S. R.	264.35	42,738
18	M. Z. K.	309.44	50,028
19	F. P. E.	146.49	23,683
20	B. Sh. H.	220.52	35,652
21	K. Q. B.	130.79	21,145
22	E. Z. K.	101.15	16,353
23	Q. B. C.	157.3	25,431
24	H. R. E.	179.1	28,955
25	C. M. Xh.	252.2	40,774
26	Xh. I. Gj.	96.8	15,650
27	K. V. D.	182.8	29,554
28	A. S. H.	226.5	36,619
29	E. B. P.	97.3	15,730
30	Sh. L. C.	435.3	70,377
31	L. T. H.	121.9	19,708
32	Sh. G. Sh.	476.5	77,038
<b>TOTALI</b>		<b>16398.26</b>	<b>1,099,220</b>

**Konstatimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve informale dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Elbasan (ish- Aluizni Elbasan) janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **32 persona** me vlerë **1,099,220 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Belsh**, rezulton se nga Drejtoria e Urbanistikës, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c.

- *Për realizimin e të ardhurave nga sipërfaqet e dhëna me qira nga fondi pyjor dhe kulloror në Bashkinë Belsh, dokumentet e lejeve minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh:*

Dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Belsh, rezultojnë 4 subjekte, ne zbatim te VKM nr.391 date 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave" i

ndryshuar. Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MIE dhe statusi i tyre për vitin 2023:

Nr.	Leje	Data e lejes	Emri i Subjektit	NIPTI	Vendburimi	Sip=k m <sup>2</sup>	Tarifa lek/ha	Tarif vjetore	Vite shfrytzimi sipas lejes	Detyrimi	DEBI	KREDI
1	850/1	18.09.2015	A. D. sh.p.k	J.....	Shkambi i zekthit	0.0319	440,000	14,036	8	112,288	112,288	0
2	1735	15.12.2014	J. 20.... sh.p.k	L.....	Perroi Cenes	0.05	440,000	22,000	9	198,000	-	198,000
3	1746	30.03.2015	I. E. sh.p.k	K.....	Gurore Kosove	0.456	440,000	200,640	8	1,605,120	1,605,120	0
4	1847	13.09.2017	H. 20.... sh.p.k	L.....	Gurore Cerrage	0.177	440,000	77,880	6	467,280	467,280	0
<b>SHUMA E DETYRIMIT</b>						<b>0.7149</b>	<b>440,000</b>	<b>314,556</b>		<b>2,382,688</b>	<b>2,184,688</b>	<b>198,000</b>

**Konstatim:** Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, konstatohet se nga Bashkia Belsh, nuk është vepruar për të dhënë me qira, sipërfaqet pyjore dhe kullimore për të cilat duhet të lidhte kontrata qiraje, të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë me subjektet e trajtuara në vijim.

Subjektet e sipërpërmendura nuk kanë lidhur kontrata me Bashkinë Belsh, gjithashtu janë njoftuar mbi këtë detyrim sipas rekomandimeve të mëparshme “Njoftim për tarifën e shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore kullimore”. Subjekti J. 20..... shpk me Nipt: L..... date 24.10.2023 sipas njoftimeve ka shlyer detyrimin për 9 vite (2015-2023) me vlerë 198,000 lekë.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. D. P., Përgjegjësi i Sektorit të të Ardhurave Vendore.*

**Pika 2.2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2023 u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Belsh, si vijon:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci), viti 2023;
2. Pasqyra e performancës financiare (PASH), viti 2023;
3. Pasqyra e flukseve monetare, viti 2023;
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, viti 2023;
5. Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit, viti 2023;
6. Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), viti 2023;
7. Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto), viti 2023;
8. Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, viti 2023;
9. Inventari për vitin 2023; etj.

**Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua:**

Në Bashkinë Belsh, janë hartuar dhe miratuar pasqyrat financiare për periudhën objekt auditimi, viti 2023.

Bashkia Belsh për vitin 2023, ka përgatitur dhe dërguar brenda afateve ligjore pasqyrat financiare në Degën e Thesarit Elbasan, me shkresë përcjellëse nr. 1189 prot., datë 26.03.2024, protokolluar nga Dega e Thesarit me nr. 297 prot., datë 27.03.2024.

- Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Belsh, për regjistrimin dhe kontabilizimin e veprimeve financiare nuk përdor asnjë program specifik financiar, por të gjitha regjistrimet, kontabilizimet dhe mbajtja e llogarive realizohet nëpërmjet Excel.

- Pasqyra e pozicionit financiar – **Viti 2023**

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet – Pasivet = **3,409,746,095** lekë.
- Aktivet **3,671,454,299** lekë
- Pasivet **261,708,204** lekë
- Aktivet neto **3,409,746,095** lekë.

### **Aktivët Afatshkurtra**

Aktivët afatshkurtra më datë **31.12.2023** janë paraqitur në vlerën **349,481,203** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **120,925,054** lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **31,251,808** lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **74,565,736** lekë;
- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **122,738,605** lekë.

### **Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:**

Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023 është në vlerën **120,925,054** lekë, e cila rakordon me pasqyrën e flukseve monetare (cash flow) rubrika V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën **148,553,794** lekë dhe rubrika VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **120,925,054** lekë, ku kjo e fundit përbëhet nga vlera e llogarisë 520 (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”). Vlera e llogarisë 520 për vitin 2023 është e njëjtë me vlerën e paraqitur në akt rakordimin e thesarit për këtë vit. Gjithashtu është paraqitur edhe detajimi analitik për fondet e trashëguara, pjesë e llogarisë 520 në fund të vitit 2023 (Aneksi, tabela nr.1).

- **Gjendje Inventari qarkullues**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Belsh në 31.12.2023 janë paraqitur në vlerën **31,251,808** lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën **3,573,500** lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën **27,678,308** lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën **(2,183,202)** lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në vlerën **2,183,202** lekë.

*Tabela nr.1 Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2023*

<b>Llogaritë kontabël</b>	<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Viti 2023</b>	<b>Viti 2022</b>	<b>Diferenca 2023 – 2022</b>
<b>31</b>	Materiale	3,573,500	4,774,197	(1,200,697)
<b>32</b>	Inventar i imet	27,678,308	28,660,813	(982,505)
<b>33</b>	Prodhim nre proces	-	-	-
<b>34</b>	Produkte	-	-	-
<b>35</b>	Mallra	-	-	-
<b>36</b>	Kafshe ne rritje e majmeri	-	-	-
<b>37</b>	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve	-	-	-
<b>38</b>	Diferenca nga cmimet e magazinimit	-	-	-
<b>39</b>	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>31,251,808</b>	<b>33,435,010</b>	<b>(2,183,202)</b>

*Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore*

**Llogaria 31 “Materiale”** për vitin 2023, ka vlerën 3,573,500 lekë dhe **Llogaria 32 “Inventar i imët”**, ka vlerën 27,678,308 lekë.

Tabela nr.2 Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2023

Viti 2023		
Llogaria	Llog. 31	Llog. 32
Gjendja në fillim të vitit	4,774,197	28,660,813
Hyrjet	20,787,485	2,661,315
Daljet	21,988,181	3,643,821
Gjendja në fund të vitit	3,573,500	27,678,308
Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci)	3,573,500	27,678,308
<b>Diferenca</b>	-	-

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

### Llogaritë e Arkëtueshme

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** për vitin 2023, ka rezultuar në vlerën **55,524,044** lekë. Shtesat për këtë llogari gjatë vitit përbëhen nga vlera e gjobave prej 27,000 lekë, ndërsa arkëtime nuk janë realizuar.

Tabela nr.3 Gjobat e vendosura, viti 2023

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Gjobe Parkimi	1,000
2	Gjobe Parkimi	1,000
3	Gjobe ndertim pa leje	15,000
4	Gjobe zaptimi hapsire	10,000
<b>TOTALI</b>		<b>27,000</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

Gjendja e debitorëve në fund të vitit 2023, bazuar në të dhënat e tabelës si vijon, rezulton në vlerën **55,486,044** lekë.

Tabela nr.4 Gjendja e debitorëve 2023

Bashkia dhe NjA	Përshkrimi	Nr. Subjekte Fizik/Juridik dhe gjoba Inspektoriati	Gjendja 31.12.2021	Viti 2022			Viti 2023		
				Debi	Kredi	Mbetja 31.12.2022	Debi	Kredi	Mbetja 31.12.2023
Bashkia Belsh	Debitor nga KLSH		54,344,044	0	0	54,344,044	0	0	54,344,044
	Debitorë nga APP		900,000	0	0	900,000	0	0	900,000
	Gjoba Insp. Ndertimi dhe Policia Bashkiake		196,000	19,000	0	215,000	27,000	0	242,000
<b>TOTALI</b>			<b>55,440,044</b>	19,000	0	<b>55,459,044</b>	27,000	0	<b>55,486,044</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr.5 Debitorët gjithsej në fund të vitit 2023

Lista e Debitoreve 2013 - 2023	
Debitorë KLSH	48,326,044
Debitorë nga APP	900,000
Gjoba nga Inspektoriati i Mbrojtjes se territorit	6,000,000
Gjobe sipas Policise Bashkiake	18,000
Gjoba te pa arketuara	37,000
Gjobe Ndertim pa Leje	180,000
Pengese rruge	10,000
Hedhje plehera ne rruge	5,000
Token shteti zaptim	10,000
<b>Totali</b>	<b>55,486,044</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

### **Konkluzion:**

Sipas tabelave të detajuara me të dhëna të vëna në dispozicion nga sektori i financës, debitorët paraqiten në vlerën **55,486,044** lekë, ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” janë paraqitur në vlerën **55,524,044** lekë. Këto dy vlera  nuk kuadrojnë  me njëra – tjetrën dhe si rrjedhojë diferenca rezulton në vlerën 38,000 lekë, duke e nënvlerësuar këtë llogari me këtë vlerë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1<sup>3</sup>; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar.

Tabela nr.6 Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, viti 2023

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023 – 2022
	<b>Llogari te Arketushme</b>			
<b>411</b>	Kliente e llogari te ngjashme	-	-	0
<b>423,429</b>	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	-	-	0
<b>431</b>	Tatim e Taksa	-	-	0
<b>432</b>	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	-	-	0
<b>433</b>	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti	-	-	0
<b>435</b>	Sigurime Shoqerore	-	-	0
<b>436</b>	Sigurime Shendetstore	-	-	0
<b>437,438,</b>	Organizma te tjere shtetore	-	-	0
<b>44</b>	Institucione te tjera publike	-	-	0
<b>465</b>	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere	-	-	0
<b>468</b>	Debitorë të ndryshëm	55,524,044	57,407,344	(1,883,300)
<b>4342</b>	Operacione me shtetin(Te drejta)	19,041,692	15,386,601	3,655,092
<b>45</b>	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	-	-	0
<b>49</b>	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	-	-	0
	<b>TOTALI</b>	<b>74,565,736</b>	<b>72,793,945</b>	<b>1,771,792</b>
	<b>Te tjera aktive afatshkurtra</b>			
<b>409</b>	Parapagime	-	-	0
<b>473</b>	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin	-	-	0
<b>477</b>	Diferenca konvertimi aktive	-	-	0
<b>481</b>	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime	-	-	0
<b>486</b>	Shpenzime te periudhave te ardhshme	122,738,605	417,951,303	(295,212,698)
	<b>TOTALI</b>	<b>122,738,605</b>	<b>417,951,303</b>	<b>(295,212,698)</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

Nga grupi i auditimit u konstatua se **llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”**, për vitin 2023, ka rezultuar në vlerën **19,041,692** lekë. Te kjo llogari janë përfshirë detyrimet për pagat e personelit, që i përkasin muajit dhjetor 2023 dhe që paguhen në janar të vitit pasardhës. Vlera e kësaj llogarie kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” te pasqyra e performancës financiare që ka rezultuar në vlerën **19,041,692** lekë.

Nga grupi i auditimit u konstatua se **llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, për vitin 2023, ka rezultuar në vlerën **122,738,605** lekë. Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë shpenzime të kryera që i përkasin periudhave të ardhshme. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen

<sup>3</sup> Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike.



e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” që në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur me tepricë kreditore në vlerën **518,075** lekë.

**Konkluzion:**

Si rrjedhojë e vlerave jo të njejta të llogarive 486 dhe 467, këto llogari nuk kuadrojnë me njëra – tjetrën. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1<sup>4</sup>; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, pika 42.

Pavarësisht këtij fakti, grupit të auditimit ju vu në dispozicion nga sektori i financës detajimi i llogarive si vijon:

Tabela nr.7 Detyrimet për shpenzimet e periudhave të ardhshme dhe aktuale, viti 2023

Llogaria	Përshkrimi	Debi	Kredi
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	122,738,605	-
604	Transferime korente te brendshme	3,485,292	-
602	Blerje mallra e sherbime	518,075	-
467	Kreditorë te ndryshem	-	518,075
401	Furnitore e llogari te lidhura me to	-	126,223,897
<b>TOTALI</b>		<b>126,741,972</b>	<b>126,741,972</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

Në tabelën e mësipërme pasqyrohen detyrimet aktuale sipas pasqyrës së pozicionit financiar për llogaritë 467 dhe 401, të cilat si kundërpanti kanë pasur shpenzime në periudhën aktuale (llogaritë 602 dhe 604) dhe shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria 486). Pra në tabelën e mësipërme paraqitet gjendja e kuadruar e këtyre llogarive pavarësisht mospërputhjes së llogarive 486 dhe 467.

• **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”,** për vitin 2023 paraqitet e detajuar për vlerën totale **122,738,605** lekë, si vijon:

Tabela nr.8 Detajimi i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, viti 2023

Nr.	Emri i Furnitorit	Emri i kontratës	Data origjinale e faturës	Numri serial i faturës	Vlera e faturës
1	F. Sh.p.k	Permiresimi i kushteve te banimit	26.02.2018	70264121	83,493
2	F. Sh.p.k	Permiresimi i kushteve te banimit	23.05.2019	70265327	1,005,437
3	F. Sh.p.k	Permiresimi i kushteve te banimit	17.02.2020	79418969	146,160
4	P. P. Sh.p.k	Performance dhe realizimi i veprave te artit liqeni Belsh	10.10.2017	2336598	4,800,000
5	P. P. Sh.p.k	Performance dhe realizimi i veprave te artit liqeni Belsh	20.11.2017	57035451	3,600,000
6	E. sh.p.k	Situacion nr.14 Furnizim me uje te pijshem i zones se Dumrese, Faza III	10.05.2023	65/2023	28,384,697
7	E. sh.p.k	Situacion nr.15 Furnizim me uje te pijshem i zones se Dumrese, Faza III	06.06.2023	69/2023	56,605,648
8	B. sh.p.k	Rikonstruksion dhe asfaltim rruga kryesore qyteti Belsh	06.12.2012	78	5,577,736

<sup>4</sup> Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike.

9	V. H. Shpk	Projektim i asambllit rilindja	04.12.2017	44153478	14,176,193
10	A. M. K.	Kolaudim Punimesh Shkolla Seferan	14.12.2021	71/2021	108,000
11	A. M.	Situacioni per projektin e rrjetit ABC per magazinën bujqesore	12.05.2022	13/2022	47,451
12	L. K.	Kolaudim punimesh	08.09.2023	11/2023	36,000
13	K. B.	Mbikeqyrje punimesh rikualifikimi urban i fasadave	27.10.2023	2/2023	100,000
14	V. H.	Rikonstruksioni i ujesjellesit Faza II	07.12.2023	148/2023	7,767,790
15	L. K.	Mbikeqyrje punimesh	28.12.2023	17/2023	300,000
<b>TOTALI</b>					<b>122,738,605</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

Të gjitha detyrimet e prapambetura të Bashkisë Belsh bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i financës e kanë vlerën **126,741,972** lekë, si më poshtë:

Tabela nr.9 Detyrimet e Bashkisë Belsh në fund të vitit 2023

Emri i Furnitorit	Data e Kontrates	Emri i kontrates	Shuma totale e kontrates	Shuma e paguar në 31 Dhjetor 2023	Shuma e mbetur papaguar në 31 Dhjetor 2023	Data origjinale e faturës	Numri serial i faturës	Shuma e faturës
F. Sh.p.k	30.12.2019	Permiresimi i kushteve te banimit	83,493	-	83,493	26.02.2018	70264121	83,493
F. Sh.p.k	30.12.2019	Permiresimi i kushteve te banimit	1,005,437	-	1,005,437	23.05.2019	70265327	1,005,437
F. Sh.p.k	17.02.2020	Permiresimi ikushteve te banimit	146,160	-	146,160	17.02.2020	79418969	146,160
P. P. Sh.p.k	05.06.2020	Performance dhe realizimi i veprave te artit ligeni belsh	4,800,000	-	4,800,000	10.10.2017	2336598	4,800,000
P. P. Sh.p.k	05.06.2020	Performance dhe realizimi i veprave te artit ligeni belsh	3,600,000	-	3,600,000	20.11.2017	57035451	3,600,000
E. sh.p.k	10.05.2023	Situacion nr.14 Furnizim me uje te pjeshem i zones se Dumrese, Faza III	85,424,291	57,039,594	28,384,697	10.05.2023	65/2023	28,384,697
E. sh.p.k	06.06.2023	Situacion nr.15 Furnizim me uje te pjeshem i zones se Dumrese, Faza III	56,605,648	-	56,605,648	06.06.2023	69/2023	56,605,648
<b>Shuma e Objekteve te investimit parashikuar me fondet e Qeverise</b>								<b>94,625,435</b>
B. sh.p.k	06.12.2012	Rikonstruksion dhe asfaltim rruga kryesore qyteti belsh	5,577,736	-	5,577,736	06.12.2012	78	5,577,736
V. H. Shpk	04.12.2017	Projektim i asambllit rilindja	34,975,992	20,799,799	14,176,193	04.12.2017	44153478	14,176,193
A. M. K.	28.02.2022	Kolaudim Punimesh Shkolla Seferan	108,000	-	108,000	14.12.2021	71/2021	108,000
A. M.	12.05.2022	Situacioni per projektin e rrjetit ABC per	1,052,502	1,005,051	47,451	12.05.2022	13/2022	47,451



		magazinen bujqesore						
L. K.	08.09.2023	Kolaudim punimesh	36,000	-	36,000	08.09.2023	11/2023	36,000
K. B.	27.10.2023	Mbikeqyrje punimesh rikualifikimi urban i fasadave	100,000	-	100,000	27.10.2023	2/2023	100,000
<b>Shuma e Objekteve te investimit parashikuar me fondet e Bashkise</b>								<b>20,045,380</b>
<b>TOTALI (1)</b>								<b>114,670,815</b>
V. H.		Furnizim me uje	102,303,206	94,535,416	7,767,790	07.12.2023	148/2023	7,767,790
<b>Shuma e Objekteve te investimit parashikuar me fondet e Qeverise</b>								<b>7,767,790</b>
L. K.		Mbikeqyrje punimesh	300,000.0		300,000.0	28.12.2023	17/2023	300,000
<b>Shuma e Objekteve te investimit parashikuar me fondet e Bashkise</b>								<b>300,000</b>
K. SHPK	Fatura/ Detyrime te cilet nuk kane mbushur 60 dite nga data e leshimit	Sherbim pastrimi	827,285.0		827,285.0	31.12.2023	4/2023	827,285
K.SHPK		Sherbim pastrimi	727,253.0	600,000	127,253.0	01.12.2023	116/2023	127,253
I. N. 2021		Vleresim Teknik	400,000.0	-	400,000.0	12.12.2023	826/2023	400,000
E.T.		Mirembajtja e kopshtit	284,400	-	284,400	20.12.2023	40/2023	284,400
A. T. SHPK 20.....		Materiale piroteknike	20,000	-	20,000	30.12.2023	447/2023	20,000
4...		Blerje produkte ushqimore	359,424	250,468	108,956	29.12.2023	1078/2023	108,959
Energji elektrike		Energji elektrike Dhjetor 2023	1,071,789		1,071,789	31.12.2023	Perbledhese	1,071,789
Uje		Detyrime uje I pijshem Dhjetor 2023	68,769		68,769	31.12.2023	Perbledhese	68,769
Sherbim posta		Sherbime postare te prapambetura 2023	13,045		13,045	31.12.2023	05/2024	13,045
Kuota e keshillit qarkut		Kuota per keshillin nga viti 2023	563,792		563,792	31.12.2023	3	563,792
<b>Mallra dhe Sherbime parashikuar me fondet e Bashkise</b>								<b>3,485,292</b>
<b>Shperblime Keshilli Bashkiak, shperblime nga viti 2023</b>								<b>518,075</b>
<b>Te tjera parashikuar me fondet e Bashkise</b>								<b>518,075</b>
<b>TOTALI (2)</b>								<b>12,071,157</b>
<b>TOTALI (1) + (2)</b>								<b>126,741,972</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

Pjesë e vlerës prej 126,741,972 lekë e detyrimeve të prapambetura të vitit 2023, është edhe vlera e shpërblimeve të Këshillit Bashkiak që rezulton në vlerën 518,075 lekë (llogaria 467) paraqitur si vijon.

Tabela nr.10 Shpërblimet e Këshillit Bashkiak pjesë e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm", viti 2023

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Vlera në lekë
1	Shpërblime Këshilli Bashkiak, shpërblime nga viti 2023	1	518,075
2	-	-	-
<b>TOTALI</b>			<b>518,075</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr.11 Tabela për vendimet gjyqësore, viti 2023

Nr.	Përfituesi	Shuma e përfitimit	Data e vendimit Gjykatës	Arsyeja	Shuma e likuiduar nga Ministria	Shuma Likuiduar nga Bashkia Belsh 2023	Shuma e mbetur
-----	------------	--------------------	--------------------------	---------	---------------------------------	--	----------------

1	S. T.	14,123,657	Gjykata e Apelit nr.185 dt.19.03.2021	Shpronosim prone	9,440,995	4,682,662	-	4,682,662
2	C. T.	10,569,788	Gjykata e Apelit nr.485 dt.26.06.2023	Shpronosim prone	-	10,569,788	-	10,569,788
<b>Totali</b>		<b>24,693,445</b>			<b>-</b>	<b>15,252,450</b>	<b>-</b>	<b>15,252,450</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

### **Konkluzion:**

Vlera e vendimeve gjyqësore të palikuiduara deri në 31.12.2023 është **15,252,450** lekë, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023 (si debitim i llogarisë 486 dhe kreditim i llogarisë 467), duke sjellë kështu një vlerë më të ulët të paraqitjes së detyrimeve të prapambetura duke e nënvlerësuar këtë llogari për këtë vlerë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1<sup>5</sup>; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, pika 42.

### **Aktivitet afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”,** për vitin 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar janë paraqitur në vlerën **24,567,890** lekë, vlerë e cila përfaqësohet vetëm nga vlera e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën **24,567,890** lekë. Kosto historike e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën **51,142,547** lekë. Të njëjtat të dhëna paraqiten gjithashtu sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe formatit 7/b “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

Tabela nr.12 Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo Materiale”, viti 2023 (kosto historike 7/a)

Llog. Kontabël	Përshkrimi i llogarive	Gjendja në fillim të vitit 2023	Shtesa (Blerje me pagesë)	Pakësime Të tjera	Gjendja në fund të vitit 2023
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	-	-	-	-
202	Studime dhe kerkime	51,142,546	3,596,400	3,596,400	51,142,546
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>51,142,546</b>	<b>3,596,400</b>	<b>3,596,400</b>	<b>51,142,546</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

**Llogaritë e klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”,** për vitin 2023, sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto) formati 7/b, vlera kontabël neto paraqitet në shumën **2,249,979,004** lekë, pas amortizimit që ka qenë në vlerën **766,955,237** lekë. Ndërsa sipas pasqyrës së gjendjeve dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike) formati 7/a, gjendja në fund pas shtesave dhe pakësimeve, në mbylljen e vitit ushtrimor 2023, paraqitet në vlerën **3,016,934,241** lekë.

Tabela nr.13 Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”, viti 2023 (kosto historike 7/a)

Përshkrimi i llogarive	Shtesa	Pakësime
------------------------	--------	----------

<sup>5</sup> Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike.

Llog. Kontabël		Gjendja në fillim të vitit 2023	Blerje e krijuar me pagesë	Shtesa pa pagesë				Gjendja në fund
				Jashtë sistemit	Brenda Sistemit	Njerrje jashtë përdorimi	Pakësime të tjera	
210	Toka,troje,Terene	5,263,276	-	-	-	-	-	5,263,276
211	Pyje,Kullota Plantacione	7,969,600	1,597,320	-	-	-	-	9,566,920
212	Ndertime e Konstruksione	717,560,978	22,500,287	25,929,755	-	-	-	765,991,020
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,094,419,942	6,010,633	-	-	-	-	2,100,430,575
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	50,028,880	1,096,358	111,600	-	3,168,833	1,005,600	47,062,405
215	Mjete transporti	61,560,583	1,075,200	914,620	-	700,000	11,604,600	51,245,803
216	Rezerva shtetore	-	-	-	-	-	-	0
217	Kafshe pune e prodhimi	288,000	-	-	-	-	-	288,000
218	Inventar ekonomik	37,139,573	358,440	67,956	-	331,370	148,356	37,086,243
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	-	-	-	-	-	-	-
28	Caktime	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>2,974,230,831</b>	<b>32,638,238</b>	<b>27,023,931</b>	<b>-</b>	<b>4,200,203</b>	<b>12,758,556</b>	<b>3,016,934,241</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

Tabela nr.14 Pasqyra nr. 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto”, viti 2023

Nr. Reference Llog.	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakesimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
20	28,903,400	3,596,400	4,335,510	3,596,400	0	51,142,546	26,574,656	24,567,890
201	-	-	-	-	-	-	-	-
202	28,903,400	3,596,400	4,335,510	3,596,400	-	51,142,546	26,574,656	24,567,890
203	-	-	-	-	-	-	-	-
21- 28	2,323,140,368	59,662,169	120,045,773	16,958,759	4,181,000	3,016,934,241	766,955,237	2,249,979,004
210	5,263,276	-	-	-	-	5,263,276	-	5,263,276
211	7,969,600	1,597,320	-	-	-	9,566,920	-	9,566,920
212	579,258,344	48,430,042	28,962,917	-	-	765,991,020	167,265,550	598,725,469
213	1,644,824,970	6,010,633	82,241,249	-	-	2,100,430,575	531,836,220	1,568,594,355
214	28,486,288	1,207,958	1,477,149	4,174,433	3,150,000	47,062,405	19,869,740	27,192,664
215	31,325,386	1,989,820	6,265,077	12,304,600	700,000	51,245,803	35,800,274	15,445,529
216	-	-	-	-	-	-	-	-
217	288,000	-	-	-	-	288,000	-	288,000
218	25,724,502	426,396	1,099,382	479,726	331,000	37,086,243	12,183,452	24,902,791
24	-	-	-	-	-	-	-	-
28	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>2,352,043,768</b>	<b>63,258,569</b>	<b>124,381,284</b>	<b>20,555,159</b>	<b>4,181,000</b>	<b>3,068,076,787</b>	<b>793,529,893</b>	<b>2,274,546,894</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

Referuar pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit të akumuluar në fund të vitit 2023 për klasat e aktiveve, është përlogaritur në vlerën prej **(793,529,893)** lekë.

Për aktivet afatgjata materiale amortizimi i akumuluar rezulton në vlerën **(766,955,237)** lekë dhe është llogaritur duke debituar llogarinë nr. 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), përkundrejt kreditimit të llogarisë nr. 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 167,265,550 lekë, llogarisë nr. 2193 në vlerën 531,836,220 lekë, llogarisë nr. 2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën 19,869,740 lekë, llogarisë nr. 2195 në vlerën 35,800,274 lekë dhe llogarisë nr. 2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 12,183,452 lekë. Ndërsa për aktivet afatgjata jomateriale amortizimi i akumuluar rezulton në vlerën **(26,574,656)** lekë.

**Llogaria 210 “Toka, troje, Terene”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **5,263,276** lekë, vlerë e cila është e njëjtë me detajimin analitik të kësaj llogarie (kosto historike në fund).

Tabela nr.15 Llogaria analitike 210 “Toka, troje, Terene”, viti 2023

LLOGARIA 210					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Cmimi	Sasia	Totali
1	Fusha futbollit	cope	335,276	1	335,276
2	Shpenzime per shpronësime	cope	4,928,000	1	4,928,000
<b>TOTALI</b>					<b>5,263,276</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

**Konkluzion:**

Në Bashkinë Belsh nuk janë hartuar grupe pune për të identifikuar asetet që janë në pronësi të Bashkisë Belsh, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale përkatëse asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo Bashki. Si rrjedhojë e këtij fakti rezulton se, asetet e paidentifikuara që janë në pronësi të Bashkisë Belsh dhe Njësive Administrative të saj nuk janë pasqyruar si pjesë e llogarisë 210 “Toka, troje, Terene”, duke sjellë kështu një vlerë të nënvlerësuar përsa i takon aseteve të përfshira në këtë llogari. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar; Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”; dhe VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, pikat 9, 10, 11 dhe 22.*

**Llogaria 211 “Pyje,Kullota Plantacione”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **9,566,920** lekë, vlerë e cila është e njëjtë me detajimin analitik të kësaj llogarie (kosto historike në fund). Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.3).

**Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **598,725,469** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.4). Vlera e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është e njëjtë me vlerën e po kësaj llogarie të paraqitur në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”. Kosto historike e llogarisë 212 në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 765,991,020 lekë.

**Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **1,568,594,355** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.5). Vlera e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është e njëjtë me vlerën e po kësaj llogarie

të paraqitur në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”. Kosto historike e llogarisë 213 në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,100,430,575 lekë.

**Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **27,192,664** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.6). Vlera e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është e njëjtë me vlerën e po kësaj llogarie të paraqitur në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”. Kosto historike e llogarisë 214 në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 47,062,405 lekë.

**Llogaria 215 “Mjete transporti”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **15,445,529** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.7). Vlera e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është e njëjtë me vlerën e po kësaj llogarie të paraqitur në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”. Kosto historike e llogarisë 215 në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 51,245,803 lekë.

**Llogaria 217 “Kafshë pune e prodhimi”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **288,000** lekë, vlerë e cila është e njëjtë me detajimin analitik të kësaj llogarie. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.8). Kosto historike e llogarisë 217 në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 288,000 lekë.

**Llogaria 218 “Inventari ekonomik”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **24,902,791** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie përkon me inventarizimin e inventarit ekonomik. Vlera e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është e njëjtë me vlerën e po kësaj llogarie të paraqitur në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”. Kosto historike e llogarisë 218 në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 37,086,243 lekë.

#### **Amortizimi për vitin 2023:**

- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”, vlera e amortizimit pas shtesës prej 1,207,958 lekë që ka pasur kjo llogari, ka rezultuar në vlerën prej 1,477,149 lekë. Evidentohet se norma e përdorur e amortizimit në këtë rast ka qenë 20%, ndërkohë që në këtë llogari janë përfshirë kompjutera dhe pajisje të tjera elektronike që e kanë normën e amortizimit 25%. Në këtë rast amortizimi është llogaritur në vlerë jo të saktë.
- Llogaria 218 “Inventari ekonomik”, vlera e amortizimit pas shtesës prej 426,396 lekë që ka pasur kjo llogari, ka rezultuar në vlerën prej 1,099,382 lekë. Evidentohet se norma e përdorur e amortizimit në këtë rast ka qenë 20%, ndërkohë që në këtë llogari janë përfshirë edhe aktive të tjera afatgjata materiale si kompjutera, laptopë, printera dhe monitorë që e kanë normën e amortizimit 25%. Në këtë rast amortizimi është llogaritur në vlerë jo të saktë.

#### **Konkluzion:**

Nga auditimi evidentohet se përllogaritja e amortizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale për vitin 2023 nuk është zbatuar saktë për të gjitha aktivet afatgjata materiale, si rrjedhojë e mos përdorimit të normave të sakta të amortizimit, sipas llojit specifik të aktivitetit dhe sipas rregullave të llogaritjes së tij për secilën kategori aktivesh. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, pika 36.*

Për Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM), paraqiten shtesat për çdo llogari si vijon:

- Objekti “Pemë Dekorative” në vlerën 1,597,320 lekë sipas kontratës nr. 47/6, datë 15.03.2023, me vlerë 1,597,320 lekë.
- Objekti “Kolaudim punimesh Rikonstruksion i pjesshëm i godinës "Qendra shëndetësore Belsh" me përshtatje për zyra për aparatin Bashkia Belsh” në vlerën 38,400 lekë sipas kontratës nr. -, datë 28.12.2026, me vlerë 38,400 lekë.
- Objekti “Mbikqyrje punimesh “Përmirësim i kushteve të Banimit për komunitetet në nevojë 2021” në vlerën 474,922 lekë sipas kontratës nr. 3469/3, datë 18.11.2021, me vlerë 474,922 lekë.
- Objekti “Mbikqyrje punimesh” Ndërtim i murit rrethues/sigurues në vendin e ndërtimit të magazinës bujqësore Belsh” në vlerën 99,600 lekë sipas kontratës nr. 59/1, datë 10.01.2023, me vlerë 99,600 lekë.
- Objekti “Ndërtimi i tregut Bujqësor - Blegtoral” në vlerën 21,821,845 lekë sipas kontratës nr. 2303/11, datë 01.11.2022, me vlerë 21,821,845 lekë.
- Objekti “Mbikqyrje punimesh "Rikonstruksion i pjesshëm i godinës shëndetësore Belsh, për zyra Institucioni Bashkia Belsh” në vlerën 65,200 lekë sipas kontratës nr. 661/1, datë 16.03.2021, me vlerë 65,200 lekë.
- Objekti “Blerje lënde inerte për rehabilitimin e disa rrugëve” në vlerën 2,399,904 lekë sipas kontratës nr. 48/8, datë 02.03.2023, me vlerë 2,399,904 lekë.
- Objekti “Kolaudim punimesh Kanali i Ujitjes Cerrage” në vlerën 195,143 lekë sipas kontratës nr. 07/3 , datë 07.04.2020, me vlerë 195,143 lekë.
- Objekti “Mbikqyrje punimesh linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrejtë shpërndares i ujësjellësit faza III” në vlerën 3,578,205 lekë sipas kontratës nr. 1398, datë 23.07.2020, me vlerë 3,578,205 lekë.
- Objekti “Furnizim për gjeotekstil” në vlerën 111,600 lekë sipas kontratës nr. - , datë -, me vlerë 111,600 lekë.
- Objekti “Makineri për riciklimin e kartonëve dhe plastikës” në vlerën 894,000 lekë sipas kontratës nr. - datë-, me vlerë 894,000 lekë.
- Objekti “Rimbursim TVSH për GIZ Albania” në vlerën 202,358 lekë sipas kontratës nr. -, datë -, me vlerë 202,358 lekë.
- Objekti “Blerje automjet për projektin GIZ” në vlerën 1,075,200 lekë sipas kontratës nr. -, datë-, me vlerë 1,075,200 lekë.

Të gjitha kontratat e mësipërme janë likuiduar në vlerën totale prej 32,121,398 lekë, bazuar në urdhër-shpenzimet e paraqitura në tabelën si vijon:

Tabela nr.16 Likuidimi i kontratave të llogarive të aktiveve afatgjata materiale, viti 2023

Llogaria	Urdhër shpenzimi		Fatura		Vlera e faturës	Vlera e likuiduar
	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
211	150	14.04.2023	343/2023	21.03.2023	1,229,160	1,229,160
	168	27.04.2023	466/2023	12.04.2023	368,160	368,160
212	396	04.10.2023	109	13.02.2017	38,400	38,400
	153	19.04.2023	14/2022	08.11.2022	474,922	474,922
	103	20.03.2023	05/2023	24.01.2023	99,600	99,600
	510	16.12.2022	176/2022	09.12.2022	6,277,874	6,277,874
	79	06.03.2023	36/2023	23.02.2023	4,990,200	4,990,200
	372	22.09.2023	100/2023	13.09.2023	10,553,771	10,553,771
	102	20.03.2023	02/2023	24.01.2023	65,520	65,520
213	378	26.09.2023	602/2023	04.08.2023	2,399,904	2,399,904
	567	29.12.2023	459	30.06.2020	32,524	32,524
	316	02.08.2022	12	27.11.2020	286,256	100,000

	538	23.12.2022	12	27.11.2020	286,256	186,256
	192	11.05.2023	06	08.05.2023	300,000	30,000
	539	28.12.2023	13/2023	13.12.2023	2,991,949	2,991,949
214	306	03.08.2023	1749/2023	03.08.2023	111,600	111,600
	526	21.12.2023	111600	24.11.2023	894,000	894,000
	85	13.03.2023	Rimbursim tvsh për investim me GIZ		202,358	202,358
215	156	19.04.2023	12/2023	28.03.223	1,075,200	1,075,200
<b>TOTALI</b>					<b>32,677,654</b>	<b>32,121,398</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

### **Në lidhje me Inventarizimin e aseteve:**

Procesi i inventarizimit në Bashkinë Belsh është realizuar bazuar në Urdhër Nr. 70, datë 21.11.2023 “Mbi ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve dhe materialeve për vitin 2023”. Komisioni është krijuar bazuar në Urdhër Nr 71, datë 21.11.2023 “Mbi ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve dhe materialeve për vitin 2023” i përbërë nga:

1. K. S.
2. A. M.
3. Dh. I.
4. O. N.
5. R. U.

Nga auditimi evidentohet se pas fazës së inventarizimit fizik nuk është hartuar urdhër për fazën e vlerësimit të aktiveve, si dhe nuk është përcaktuar komisioni përkatës që ka kryer vlerësimin, për të vijuar më tej me fazat e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimin sipas rastit dhe nevojës. Si rrjedhojë e kësaj procesi i inventarizimit për këto aktive nuk është kryer i plotë. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 95 – 106.

Nga auditimi rezulton se nuk është hartuar një Procesverbal Vlerësimi pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, rubrika Proces verbali i vlerësimit, pika 104 – 105.

Gjithashtu evidentohet se nuk është hartuar një relacion i vlerësimit me qëllim përshkrimin e gjithë procedurës së ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet etj. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, rubrika Relacioni i Vlerësimit, pika 106<sup>6</sup>.

Për procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk është hartuar urdhër për fillimin e këtij procesi si dhe nuk është përcaktuar komisioni përkatës që do të realizojë këtë fazë të procesit të inventarizimit. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe

<sup>6</sup> Relacioni i vlerësimit - 106. Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.



*Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 100<sup>7</sup> dhe 107 – 109.*

Në Bashkinë Belsh është hartuar Realcion “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe materialeve (Inventar Ekonomik, Instalime Teknike, Pajisje, Vegla Pune) për vitin 2023 në Bashkinë Belsh, Njësitë Administrative dhe Shkollat”. Në relacion përshkruhet se “... gjatë inventarizimit janë gjetur materiale të konsumuara që kanë humbur vlerën e përdorimit dhe për to janë mbajtur procesverbale përkatëse duke përcaktuar sasinë dhe çmimin si për inventarin ekonomik dhe për inventarin e imët për çdo institucion. Në bazë të procesverbaleve të sjella për nxjerrjen jashtë përdorimit kryesisht inventar i imët, tavolina, karrige, stufa zjarri, materiale higjene etj. ...janë nxjerrë jashtë përdorimi për arsye se janë thyer ose dëmtuar në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehet në gjendje pune nëpërmjet riparimit, kanë humbur vlerën e përdorimit nga afati i gjatë dhe disa prej tyre janë materiale konsumi, nuk mund të riparohen dhe nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër ”

Vlera sipas llogarive ekonomike paraqitet:

- Llogaria 215 = 700,000 lekë
- Llogaria 214 = 3,163,833 lekë
- Llogaria 218 = 331,370 lekë
- Llogaria 327 = 2,958,498 lekë

Është hartuar Projekt – Vendim Nr. 17, datë 19.12.2023 “Për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara ose të patrupëzuara” duke përcaktuar vlerat e paraqitura si më lart për secilën kategori aktivesh. Gjithashtu është hartuar edhe Vendim Nr. 84, datë 29.12.2023 “Për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara ose të patrupëzuara”.

Për fazën e asgjесimit është hartuar Urdhër Nr. 33, datë 13.02.2024 për “Ngritjen e komisionit për grumbullimin dhe asgjесimin e aktiveve dhe materialeve jashtë përdorimit për vitin 2023” i përbërë nga:

1. O. U.
2. D. M.
3. D. P.
4. A. H.
5. K. G.

Në Proces – Verbalin për procesin e asgjесimit përcaktohet vlera prej **6,453,701** lekë e aktiveve që i janë nënshtruar këtij procesi. Gjithashtu është hartuar Proces - Verbal për shitjen në ankand të materialeve si hekurishte 29.5 kg, për përdorim të shkollave dhe Njesive Administrative te materialeve drusore dru zjarri 2.13 m<sup>3</sup> dhe gjitha materialet e tjera të groposen dhe digjen. Janë marrë masa për procedurën e ankandit me shkresën nr. 638 prot., datë 14.02.2024 “Kërkesë për fillimin e Procedurës së Ankandit” për materialet hekurishte 29.5 kg.

### **Konkluzion:**

Në Bashkinë Belsh nuk është hartuar dhe miratuar një raport i inventarizimit fizik, që të përshkruajë kushtet e ruajtjes së aktiveve, duke specifikuar se cilat aktive pas mbarimit të procesit të inventarizimit fizik kanë rezultuar të dëmtuara, të amortizura ose plotësisht të amortizuara etj. Pra nuk ka pasur një verifikim fizik dhe cilësor për aktivet, pjesë e inventarit të vitit 2023, gjë e

---

<sup>7</sup> 100. Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vete, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari ne varesi te kompetencave per nxjerrjen nga përdorimi te dhena ne paragrafet 111 deri 118 te ketij udhezimi.



cila pengon edhe verifikimin e gjendjes konkrete të aktiveve, krahasuar me rezultatin e aktiveve që mbahen në librat e financës dhe kontabilitet. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli III Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 85 c<sup>8</sup>.

Nga auditimi konstatohet se nuk është hartuar një Procesverbal për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve për vitin 2023. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, rubrika Procesverbali për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, pika 110<sup>9</sup>.

Përsa i takon aktiveve të Bashkisë Belsh nuk është përgatitur dhe miratuar një regjistër aktivesh i përditësuar. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli III Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pikat 26 – 33.

Në Bashkinë Belsh nuk është hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Ky veprim është në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika ç); Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar rubrika Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike, pika 5<sup>10</sup>.

### **Investime për aktive afatgjata**

**Llogaria 231 “Investime për Aktive Afatgjata materiale”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **1,047,426,202** lekë, ndërsa **llogaria 230 “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”** është paraqitur në vlerën **0** lekë.

- **Llogaria 230 “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”**, në pasqyrën 6 “Investimet dhe burimet e financimit” është paraqitur me tepricë në fund në vlerën **0** lekë.
- **Llogaria 231 “Investime për Aktive Afatgjata materiale”**, në pasqyrën 6 “Investimet dhe burimet e financimit” është paraqitur me tepricë në fund në vlerën **1,047,426,202** lekë.

Tabela nr.17 Llogaria analitike 230 dhe 231 “Investime”, viti 2023

<b>Llogaria 230 dhe 231 për vitin 2023</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Llog. Ekonomike</b>	<b>Vlera e likuiduar deri në 31.12.2023</b>
<b>1</b>	Sistemim dhe asfaltim i rrugeve te brendshme te fshatrave	213	36,968,336
<b>2</b>	Mbikqyrje Punimesh "Sistemim dhe asfaltim i rrugeve te brendshme te fshatrave faza I"	213	300,000
<b>3</b>	Sistemim dhe asfaltim i rruges Belsh Stanaj	213	41,042,676

<sup>8</sup> 85. Komisioni i inventarizimit ka pergjegjesine per:

c. Te perpilote nje raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, per kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe per verejtjet lidhur me karakterin e diferencave e demtimeve te konstatuara, per shkaqet e tyre dhe personat pergjegjes, dhe, se bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorezoje per veprime te metejshme Nepunesit Autorizues.

<sup>9</sup> 110. Hartohet nga komisioni per nxjerrjen nga perdorimi ne tre kopje, ku pershkruhet procedura e ndjekur sipas rastit per cdo aktiv lidhur me dhenien ne perdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashte perdorimit dhe destinacionin perfundimtar te aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

<sup>10</sup> 5. Titullari i njësisë publike eshte pergjegjes per miratimin e rregullave specifike dhe procedurave per ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve te njesisë publike ne perputhje me kerkesat e ketij udhezimi.

4	Rikonstruksioni i rruges Rrase, Hysgjokaj, Pajallinj, Beqiraj, Gradishte	213	8,825,505
5	Rikonstruksion uji i pishem faza II	213	420,000,000
6	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion uji i pishem faza II	213	3,304,479
7	Rikonstruksion uji i pishem faza III	213	484,430,792
8	Shtese kontrate asnampli rilindja Belsh	212	20,799,799
9	Trasheguar nga ish komunat sipas reformes territoriale		31,754,615
<b>TOTALI</b>			<b>1,047,426,202</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

Vlera prej 31,754,615 lekë është e trashëguar nga ish komunat sipas reformës territoriale, por nuk është e rakorduar si vlerë e saktë.

### **Pasivet (Detyrimet)**

#### ***Pasivet Afatshkurtra***

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar, janë llogari të pagueshme, të cilat paraqesin detyrimet e Bashkisë Belsh deri në 31.12.2023, si pagat e punonjësve të muajit dhjetor, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela nr.18 “Llogaritë e klasës 4”, viti 2023

Llogaritë	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023 - 2022
<b>401-408</b>	Furnitore e llogari te lidhura me to	126,223,897	420,829,802	(294,605,905)
<b>42</b>	Detyrime ndaj personelit	10,253,727	8,440,394	1,813,333
<b>16,17,18</b>	Hua Afat shkurtra	-	-	-
<b>460</b>	Huadhenes	-	-	-
<b>431</b>	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,400,440	419,649	980,791
<b>432</b>	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal	-	-	-
<b>433</b>	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore	-	-	-
<b>435</b>	Sigurime Shoqerore	2,975,880	2,848,906	126,974
<b>436</b>	Sigurime Shendetesore	408,278	390,770	17,508
<b>437,438,</b>	Organizma te tjere shteterore	-	-	-
<b>44</b>	Institucione te tjera publike	-	-	-
<b>45</b>	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	-	-	-
<b>464</b>	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	3,769,675	1,948,300	1,821,375
<b>466</b>	Kreditore per mjete ne ruajtje	64,403,863	54,842,228	9,561,635
<b>467</b>	Kreditore te ndryshem	518,075	408,383	109,693
<b>4341</b>	Operacione me shtetin( detyrime)	51,754,369	55,459,044	(3,704,675)
<b>49</b>	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>261,708,204</b>	<b>545,587,475</b>	<b>(283,879,271)</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

Llogaritë e klasës 4 për vitin 2023 janë paraqitur me një vlerë totale prej **261,708,204** lekë. Kjo vlerë ka rezultuar si rrjedhojë e llogarive përbërëse si më poshtë vijon:

• **Llogaritë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”,** janë paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **126,223,897** lekë.

Tabela nr.19 Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”, viti 2023

<b>Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”</b>	
Celje e vitit 2023	420,829,802
Shtesa (K)	172,251,129
Pakësime (D)	-466,857,034

<b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b>	<b>126,223,897</b>
----------------------------------	--------------------

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **10,253,727** lekë.

Tabela nr.20 Llogara analitike 42 “Detyrime ndaj personelit”, viti 2023

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Nr.	Datë	
1	15.01.2024	7,995,083
2	15.01.2024	10,000
3	15.01.2024	220,490
4	15.01.2024	329,128
5	15.01.2024	1,409,079
6	15.01.2024	233,698
7	15.01.2024	56,249
<b>TOTALI</b>		<b>10,253,727</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **1,400,440** lekë.

Tabela nr.21 Llogara analitike 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, viti 2023

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Nr.	Datë	
12	15.01.2024	433,521
13	16.01.2024	930,829
58	13.02.2024	36,090
<b>TOTALI</b>		<b>1,400,440</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

- **Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **2,975,880** lekë.

Tabela nr.22 Llogara analitike 435 “Sigurime Shoqërore”, viti 2023

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Nr.	Datë	
8	15.01.2024	1,799,081
9	15.01.2024	1,176,799
<b>TOTALI</b>		<b>2,975,880</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

- **Llogaria 436 “Sigurime Shëndetsore”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **408,278** lekë.

Tabela nr.23 Llogara analitike 436 “Sigurime Shëndetsore”, viti 2023

Urdher shpenzimi		Vlera në lekë
Nr.	Datë	
10	15.01.2024	204,139
11	15.01.2024	204,139
<b>TOTALI</b>		<b>408,278</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **64,403,863** lekë.

Tabela nr.24 Llogara analitike 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", viti 2023

Nr.	Nr. USH	Data	Përshkrimi	Vlera në lekë
<b>Vlera në fund të vitit 2022 (1)</b>				<b>54,842,228</b>
1	51	13.02.2023	Sistemim dhe asfaltim i rruges Belsh-Stanaj	446,267
2	79	06.03.2023	Ndertimi i tregut bujqesor-blegtoral	249,510
3	86	15.03.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	226,790
4	87	15.03.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	1,382,787
5	88	15.03.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	694,091
6	89	15.03.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	646,332
7	90	15.03.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	3,000,000
8	249	26.06.2023	Sistemim dhe asfaltim i rruges Belsh-Stanaj	663,980
9	308	08.08.2023	Sistemim dhe asfaltim i disa rrugeve te brendshme te fshatrave Bashkia Belsh faza I	1,000,000
10	372	22.09.2023	Ndertimi i tregut Bujqesor Blegtoral	527,688
11	423	24.10.2023	Sistemim dhe asfaltim i disa rrugeve te brendshme te fshatrave Bashkia Belsh faza I	300,000
12	440	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	605,144
13	441	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	1,503,509
14	442	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	950,040
15	443	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	1,515,000
16	444	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	1,680,000
17	445	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	1,626,456
18	446	09.11.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes faza III	2,119,851
19	527	21.12.2023	rikonstruksioni i rruges Rrase -hysgjokaj, pajallinj, beqiraj, Gradishte	441,275
20	534	21.12.2023	Sistemim dhe asfaltim i disa rrugeve te brendshme te fshatrave te bashkise Belsh faza e I	262,887
21	536	28.12.2023	Linja kryesore perfurnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes i ujsjellesit ne qytetin e Belshit faza III	2,148,020
22	537	28.12.2023	Linja kryesore perfurnizim me uje dhe rrjetin e shperndarjes i ujsjellesit ne qytetin e Belshit	2,851,980
23	540	28.12.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin shperndares per qytetine belshit faza II	273,229
24	541	28.12.2023	Linja kryesore per furnizim me uje dhe rrjetin shperndares per qytetine belshit faza II	4,726,771
25	547	28.12.2023	Sistemim dhe asfaltim i disa rrugeve te brendshme te fshatrave te bashkise Belsh faza e I	285,530
26	565	29.12.2023	Shtese kontrate projekti ansambli Rilindja	841,980
27			Mjete ne ruajte 466 Pulla arketuar per vitin 2023	1,131,925
<b>TOTALI (2)</b>				<b>32,101,042</b>
<b>Garanci për punime të cilruara gjatë vitit 2023 (3)</b>				<b>22,539,407</b>
<b>TOTALI QË TRASHËGOHET PËR VITIN 2024 (1) + (2) – (3)</b>				<b>64,403,863</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, përpunoi grupi i auditimit

### **Pasqyra e Performancës Financiare**

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare, për vitin 2023 vlera e të ardhurave të gjeneruara ka qenë **578,512,026** lekë, ndërsa vlera e shpenzimeve të kryera ka qenë në vlerën **522,049,436** lekë.

### **Llogaritë e klasës 7 – Të ardhurat**

- **Llogaria 70 "Të ardhura nga taksat e tatimet"**, për vitin 2023, është paraqitur në pasqyrën e performancës financiare në vlerën **40,993,484** lekë dhe përbëhet nga:
- Llogaria 700 "Tatimi mbi të Ardhurat" në vlerën 314,106 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
- Llogaria 702 "Tatimi mbi pasurinë" në vlerën 23,708,560 lekë, , e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

- Llogaria 703 “Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit” në vlerën 16,911,243 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
- Llogaria 708 “Të tjera tatime e taksa kombëtare” në vlerën 59,575 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”,** për vitin 2023, është paraqitur në pasqyrën e performancës financiare në vlerën 15,541,098 lekë. Vlera e llogarisë 71 përbëhet nga:
- Llogaria 710 “Nga ndërmarrjet dhe pronësia” në vlerën 925,098 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
- Llogaria 711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare”, në vlerën 14,522,104 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
- Llogaria 719 “Të ardhura të tjera jotatimore” në vlerën 93,896 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
- **Llogaria 72 “Grante korente”,** për vitin 2023 paraqitet në pasqyrën e performancës për vlerën 488,719,829 lekë.

Tabela nr. 25 Përbërja e llogarisë 72 “Grant korent i Brendshëm”, viti 2023

720	Grant korent i Brendshëm	Vlera në lekë
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	275,199,038
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	182,877,988
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH	-
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)	-
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	8,269,665
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	-
7206	Financim i pritshem nga buxheti	19,041,692
7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)	3,331,446
7209	Te tjera grante korente te brendshme	275,199,038
<b>TOTALI</b>		<b>488,719,829</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

- Llogaritë e klasës 7 në 31.12.2023 bazuar në akt rakordimin me thesarin kanë rezultuar në vlerën totale prej **69,267,618** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, tabela nr.9).

### **Llogaritë e klasës 6 - Shpenzimet**

Organika për vitin 2023 ka funksionuar me 229 punonjës nga këto për administratën e aparatit të Bashkisë Belsh (ku përfshihen edhe funksionet e deleguara si: Arsimi parashkollor 31 punonjës, adm. pyjeve 1 punonjës, adm. ujitja kullimi 2 punonjës, shërbimi zjarrfikës 14 punonjës, mirëmbajtja e rrugëve rurale 15 punonjës, gjendja civile 2 punonjës) 214 punonjës, Njësia Administrative Kajan 4 punonjës, Njësia Administrative Grekan 4 punonjës, Njësia Administrative Rrase 3 punonjës dhe Njësia Administrative Fierzë 4 punonjës. Në numrin e punonjësve për Njësitë Administrative është përfshire edhe punonjësi i Gjendjes Civile, me përjashtim të Njesisë Administrative Rrase që nuk ka shërbimin e Gjendjes Civile në njësi.

Tabela nr.26 Numri i punonjësve bazuar në strukturën organike, viti 2023

Emërtimi	Plan	Fakt
Aparati i Bashkisë Belsh	214	213
Njësia Administrative Kajan	4	4
Njësia Administrative Grekan	4	4
Njësia Administrative Rrase	3	3
Njësia Administrative Fierzë	4	4
<b>TOTALI</b>	<b>229</b>	<b>228</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

**Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjëseve”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **145,887,287** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Tabela nr.27 Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjëseve”, viti 2023

600	Pagat dhe përfitimet e punonjëseve	Vlera në lekë
6001	Paga, personel i perhershëm	130,773,544
6002	Paga personel i Perkohshëm	12,706,763
6003	Shperblime	-
6009	Shpenzime te tjera per personelin	2,406,980
<b>TOTALI</b>		<b>145,887,287</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

**Llogaria 601 “Kontribute të sigurimeve”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **23,706,971** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Tabela nr.28 Llogaria 601 “Kontribute të sigurimeve”, viti 2023

601	Kontribute të sigurimeve	Vlera në lekë
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	21,495,494
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	2,211,477
<b>TOTALI</b>		<b>23,706,971</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

**Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **73,828,701** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Tabela nr.29 Llogaria 602 “Blerje mallra dhe Shërbime”, viti 2023

602	Blerje mallra e shërbime	Vlera në lekë
602	Mallra dhe shërbime të tjera	-
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	6,207,226
6021	Materiale dhe shërbime speciale	6,020,543
6022	Shërbime nga të tretë	34,320,712
6023	Shpenzime transporti	12,431,292
6024	Shpenzime udhëtimi	1,385,280
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	3,025,200
6026	Shpenzime për qeramarrje	1,964,398
6027	Shpenzime për detyrime për kompesime legale	-
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	-
6029	Shpenzime të tjera operative	8,474,050
<b>TOTALI</b>		<b>73,828,701</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

**Llogaria 604 “Transferime korente të brendshme”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **5,594,005** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Tabela nr.30 Llogaria 604 “Transferime korente të brendshme”, viti 2023

604	Transferime korente të brendshme	Vlera në lekë
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	-
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme	5,594,005
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore	-
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	-
<b>TOTALI</b>		<b>5,594,005</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

**Llogaria 606, “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **265,703,899** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Tabela nr.31 Llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”, viti 2023



606	Transferime për Buxhetet familjare e Individë	Vlera në lekë
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	-
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	265,703,899
<b>TOTALI</b>		<b>265,703,899</b>

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore

*Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi ngarkohen me përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Belsh në cilësinë e nëpunësit autorizues, z. A. T.; dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues të institucionit, z. A. N.*

### **Pika 2.3. Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.**

Në zbatim të pikës 4 mbi “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve, pyje dhe kullota)”, janë administruar evidencat si më poshtë:

- *Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Belsh*
- *Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastër*
- *Inventari i fondit pyjor*
- *Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor*

#### **I. PASURITË E PALUAJTSHME**

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin.

1. Për **Bashkinë Belsh**, lista e pronave është miratuar me VKM nr.886 datë 03.11.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Belsh, të Qarkut Elbasan”. Lista e inventarit përbëhet nga 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor **1306** (një mijë e treqind e gjashtë) prona.

2. Për **ish-Komunën Kajan**, lista e pronave është miratuar me vendim nr. 71, datë 28.01.2008 “Për Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Kajan të Qarkut të Elbasanit”, me listë 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 685 (gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë).

3. Për **ish-Komunën Grekan**, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 382, datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Grekan, të Qarkut Elbasan”, fillon me listë me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 208 (dyqind e tetë). Procesi i transferimit të pronave në njesinë Administrative Grekan nuk ka përfunduar është në fazën e inventarizimit.

4. Për **ish-Komunën Rrase**, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 699, datë 19.07.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Rrase, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista paraprake inventarit. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 194 (njëqind e nentëdhjetë e kater). Procesi i transferimit të pronave në njesinë Administrative Rrase nuk ka përfunduar, është në fazën e inventarizimit.

5. Për **ish-Komunën Fierze**, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 1526, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Fierze, të



Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista paraprake inventarit. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 150 (njëqind e pesëdhjetë). Procesi i transferimit të pronave në njesinë Administrative Fierzë nuk ka përfunduar është në fazën e inventarizimit.

*Pronat e kaluara me VKM janë të regjistruara në ASHK, paraqiten si më poshtë:*

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2023	Nr. Praktikave të çertifikuara në 2023	Prona të pa Rregjistruara
1	Bashkia Belsh	1306	13	1 çertifikatë pronësie	Pjesa e mbetur e pronave
2	NJA. Kajan	685		0	Nuk ka listë përfundimtare
3	NJA. Grekan	151	1 (pasuri e llojit pyll) Vkm.pyjeve dhe kullotave)	0	Nuk ka listë përfundimtare
4	NJA. Rrase	194		0	Nuk ka listë përfundimtare
5	NJA. Fierz	150		0	Nuk ka listë përfundimtare
<b>Totali</b>					

Në total, pasuritë që i janë transferuar në pronësi Bashkisë Belsh, përfshirë ish-komunat, vetëm 14 pasuri rezultojnë me dokumentacion, çertifikatë pronësie që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar, për Bashkinë Belsh, për 1306 pronave në inventar. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

1-VKM nr.886 date 03.11.2010 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore,që transferohen në pronësi ose ne përdorim të Bashkis Belsh, të qarkut të Elbasanit.

2-VKM nr.71 date 28.01.2008 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kajan të qarkut të Elbasanit.

3-VKM nr.699 date 19.10.2007 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Rrase të qarkut të Elbasanit.

4-VKM nr.1526 date 19.11.2008 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fierzë të qarkut të Elbasanit.

5-VKM nr.912 date 19.12.2007 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Grekan të qarkut të Elbasanit.

Gjithashtu janë të trasferuara pyjet dhe kullotat sipas VKM-ve të shoqëruara me inventarët.

6-VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit”.

7-VKM Nr.684, datë 02.09.2020“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”.

### **Bashkia Belsh**

Për 13 fshatrat e Bashkisë Belsh procesi i transferimit ka përfunduar, ndërsa për njësitë Grekan, Fierzë, Kajan, Rrase transferimi është në fazën e inventarizimit dhe për këtë arsye nuk mund të aplikohet për tu paisur me çertifikate pronësie. Për vitin 2023 Bashkia Belsh, është pajisur me çertifikatë pronësie për pasurinë nr. 1/176 ndodhur në fshatin Kosovë, njësia Administrative Fierzë, pasuri e transferuar me VKM-684/2020.

Në mënyrë të detajuar pronat e pasurisë publike në administrim të Bashkisë Belsh, të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, paraqiten si vijon:

Nr.	Emertimi Pasurisë	Zona kadastral	Nr. Pasurise	Nr.	Siperfaqja sipas V.K.M	Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose	Siperfaqja sipas Faktit
-----	-------------------	----------------	--------------	-----	------------------------	--------------------------	--------------	-------------------------

				Indeksi i hartes		Truall	Ndërt		certifikatë Hipoteke	Truall	Ndërtesa
1	Kullote	1386	1/1	K-34-112-(74-B)				14/04/2023			
2	Kullote	1386	1/2	K-34-112-(74-B)				14/04/2023			
3	Kullote	1386	1/3	K-34-112-(74-B)				14/04/2023			
4	Kullote	1386	1/4	K-34-112-(74-B)(75-A)				14/04/2023			
5	Kullote	1386	1/5	K-34-112-(74-B)(75-A)				14/04/2023			
6	Kullote	1386	1/6	K-34-112-(75-A)				14/04/2023			
7	Kullote	1386	1/7	K-34-112-(75-A)				14/04/2023			
8	Kullote	1386	187/58	K-34-112-(74-B)(75-A)				14/04/2023			
9	Kullote	1386	187/60	K-34-112-(74-B)				14/04/2023			
10	Kullote	2237	1/179	K-34-112-(74-B)(75-A)(75-C)				14/04/2023			
11	Kullote	2237	1/162	K-34-112-(74-B)(74-D)				14/04/2023			
12	Kullote	2237	1/188	K-34-112-(75-C)				05/06/2023			
13	Pyll	1835	5	K-34-112-(46-D)				04/10/2023			
14	Pyll	2658	278	K-34-112-(45-A)				04/10/2023			
15	Pyll	1394	12	K-34-112-(45-A)				04/10/2023			
16	Shkembore	3272	54/2	K-34-112-(45-A)				05/10/2023			
17	Shkembore	3272	59	K-34-112-(45-A)				05/10/2023			
18	Shkembore	1386	187/59	K-34-112-(74-B)				14/04/2023			

Nga auditimi rezulton se janë aplikuar për tu çertifikuar **18** pasuri për fondin pyje/kullota/shkëmbore në administrim të Bashkisë Belsh, të cilat janë në proces dhe është administruar **1** certifikatë e regjistrimit të pasurisë, për numrin e pasurisë **1/179**, lloji i pasurisë kullotë, me sipërfaqe totale 182050 m<sup>2</sup>, me adresë të pasurisë Belsh, data e lëshimit 18.12.2023.

#### **Konkluzion:**

- Në Bashkinë Belsh nuk janë hartuar grupe pune si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale përkatëse asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Belsh dhe Njësi Administrative që përmbledh kjo Bashki.
- Bashkia Belsh nuk ka krijuar një grup/sector për administrimin e aseteve, pra veprime jo në përputhje me inventarin e pronave, në zbatim të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj për administrimin e aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre.
- Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Po kështu, për shkak se nga ana e Bashkisë Belsh nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “*Bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, Bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji*”.

- Në total, nga 1306 pasuri që i janë transferuar në pronësi Bashkisë Belsh, pa përfshirë ish-komunat, vetëm 14 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar.

Në veçanti, konstatohet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, qendrat e shëndetit publik, pronat që përdoren për veprimtari social, kulturore dhe sportive, si dhe pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.

## II.Fondi Pyjor

### Auditim mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e detyrimeve për kontratat e lidhura

Bashkia Belsh ka në administrim një fond pyjor dhe kulloror prej **1,726,76 ha**, i ndarë në **4** ekonomi pyjore sipas VKM nr.684, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Në mënyrë të detajuar ekonomia e fondit pyjor dhe e kullotave, paraqitet si vijon:

Ekonomia pyjore	Sipërfaqja totale ha	Shkëmbore	Pyll	Kullota
Dumri	1163.07	6.15	1063.63	93.29
Rrase – Xherije	514.3	0	496.12	18.18
Zalli – Devoll	45.09	0	45.09	0
Balaj	4.3	0	4.3	0
<b>Totali</b>	<b>1,726,76</b>	<b>6.15</b>	<b>1609,14</b>	<b>111,47</b>

Gjatë vitit 2023 është përpiluar një kontratë qiraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor kulloror, e lidhur me nr.3449 prot, në datë 12.12.2023 ndërmjet Bashkisë Belsh dhe Personit Fizik **O. A. SH.A** si person juridik, referuar si “*Qiramarrësi*”.

Viti 2023	Lloji	Afati	Siperfaqja	Niveli i arketimit
1-Kontratë qeraje	Fond pyjor/kullorore	9 vjecar	300 m <sup>2</sup>	240.000 leke/viti

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023, subjekti one albania sh.a është debitor në vlerën prej 67.500 lekë (për periudhën 04.11.2023 – 03.02.2024) kaluar me kamatvonesë dhe prej datës 12 Dhjetor 2023 nga momenti i rinovimit të kontratës, e në vijim, subjekti one albania sh.a është debitor në vlerën prej 240.000 lekë. Në total detyrimi është 307,500 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

### Konkluzion:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia e Belsh nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.

- Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr.443/2016, i ndryshuar me VKM nr.684, datë 02.09.2020 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kulloror publik.

- Në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kulloror, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Belsh nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: znj. A. D., në cilësinë e Përgjegjësit për Pronat Publike; z. E. Sh., në cilësinë e Drejtorit të Bujqësisë dhe Kadastrës dhe z. K. G.**

#### IV. GJETJE REKOMANDIME.

##### A. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se shpenzimet e buxhetit të vitit 2023, nga 1,311,243 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,145,577 mijë lekë ose në masën 87.3 % . Pagat (600) nga 147,130 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 143,928 mijë lekë, ose 97.8%, Sigurime shoq. (601) nga 23,889 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 23,622 mijë lekë ose 98.8%, Shpenzime operative (602) nga 118,320 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 71,544 mijë lekë, ose 60.4%, Shpenzime për ndihma nga transfertat dhe fond rezervë (604-609) nga 19,703 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 14,811 mijë lekë ose 75%; dhe Shpenzime për investime (230-231) nga 725,425 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 634,513 mijë lekë ose 87.5%. Konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative dhe investime, të cilat janë zërat më kryesor të buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky fakt vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore që nga 102,000 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 64,745 mijë lekë ose 60%, veprim jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, faqe 13 – 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Belsh, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxheteve paraardhëse me qëllimin që programimet e shpenzimeve buxhetore, të jenë sa më të argumentuar. Shpërndarja e fondeve buxhetore, planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit të bëhet mbi baza reale bazuar në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, me qëllim përdorimin me efikasitet të burimeve financiare.

*Në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se totali i detyrimeve të palikuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 35,297 mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 351,533 mijë lekë zënë 10%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 515 prot., datë 05.02.2024. Nga të dhënat e bilancit rezulton se detyrimi i faturave të pa likuiduara dhe vendime gjykate në fund të vitit 2023, që i përkasin llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” janë për vlerën 126,223,897 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” janë për vlerën 518,075 lekë, gjithsej në vlerën 126,741,972 lekë. Detyrimet e papapaguara gjithsej në vlerën 35,297 mijë lekë nga mungesa e fondeve kryesisht nga të ardhurat veta të cilat për vitin 2023 nuk janë realizuar në vlerën 45,525 mijë lekë janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40, 42, Udhëzimi i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, faqe 13 - 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Belsh, të percjellë problematikën pranë Këshillit Bashkiak lidhur me gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjithë radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, të marrë masat për t’i ekzekutuar ato në mënyrë vullnetare për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbartimore.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat rezulton se, për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore, nga vlera 102,000 mijë lekë të parashikuara, është realizuar në vlerën 56,475 mijë lekë ose 55 %, me një mosrealizim në vlerën 45,525 mijë lekë, nga të cilat: të ardhura nga taksat nga vlera 71,470 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 37,178 mijë lekë ose 52%, të ardhura tarifave nga vlera 28,320 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 7,288 mijë lekë ose 25 % dhe të ardhura të tjera nga vlera 2,090 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 1,812 mijë lekë ose 86.6 %. Mos realizimi i të ardhurave vjen si rezultat i punës jo efektive të administratës së të ardhurave dhe mos planifikimit të saktë të të ardhurave në raport me mundësitë ekonomike që ka kjo njësi vendore. Gjithashtu, konstatohet se megjithëse parashikimi është i pandryshuar nga njëra periudhë në tjetër, fakti ka një rënie nga viti 2022. Kështu arkëtimet e vitit 2022 kanë qenë në vlerën 67,450 mijë lekë, ndërsa në vitin 2023 ato janë në vlerën 56,475 mijë lekë, pra me një diferencë 10,975 mijë lekë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23, VKB nr.78 datë 15.11.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2022”.

- Në lidhje me menaxhimin e taksave/ tarifave të abonentëve familjarë, konstatohet se nuk ka një regjistër për sipërfaqen e tokës së ndarë për çdo familje dhe sipërfaqet e ndërtesave të banimit, kështu që planifikimi i tyre është bërë sipas realizimit të një viti më parë dhe jo mbi bazën e të dhënave që Sektori i të Ardhurave Vendore duhet të merrte nga regjistri elektronik i ASHK, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin taksave vendore” i ndryshuar neni 22, pika 1. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1.6 faqe 21 - 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Belsh, të marrë masa për një planifikim real të të ardhurave dhe ndjekjen e të gjitha procedurave në arkëtimin e vlerave të parashikuara, kjo për të mos krijuar diferenca me plan dhe vënien në vështirësi të bashkisë për realizimin e shpenzimeve të parashikuara për vitin ushtrimor.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Belsh nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Sipas të dhënave të detajuara të vëna në dispozicion nga sektori i financës, debitorët kanë rezultuar në vlerën 55,486,044 lekë, ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur në vlerën 55,524,044 lekë. Këto dy vlera nuk kuadrojnë me njëra – tjetrën dhe si rrjedhojë diferenca rezulton në vlerën 38,000 lekë. Si rrjedhojë e këtij fakti rezulton se në mbyllje të vitit 2023 kjo llogari është mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar, për këtë vlerë. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27 - 46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës në Bashkinë Belsh të merren masat që të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe të kryhet sistemimi i vlerës prej 38,000 lekë, me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të kësaj llogarie.

## *Me mbylljen e pasqyrave viti 2024*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Belsh nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrën e pozicionit financiar ka rezultuar në vlerën 122,738,605 lekë. Vlera e kësaj llogarie përfaqëson shpenzime të kryera që i përkasin periudhave të ardhshme. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” që në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur me tepriçë kreditore në vlerën 518,075 lekë. Veprimet që janë ndjekur për këto dy llogari tregojnë që detyrimet në llogaritë 467 dhe 401, kanë pasur si kundërparti shpenzime në periudhën aktuale (llogaritë 602 dhe 604) dhe shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria 486). Bazuar në këto veprime paraqitet gjendja e kuadruar e këtyre llogarive pavarësisht mospërputhjes së vlerave ndërmjet llogarive 486 dhe 467 në pasqyrën e pozicionit financiar. Si rrjedhojë e vlerave jo të njejta të llogarive 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm”, këto llogari nuk kuadrojnë me njëra – tjetrën. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, pika 42.

(*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27 - 46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës në Bashkinë Belsh të merren masat që të kryhen veprimet e nevojshme dhe në fund të vitit ushtrimor të paraqiten në mënyrë të saktë gjendjet e llogarive 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Belsh nga auditimi mbi vlerën e vendimeve gjyqësore të palikuiduara deri në 31.12.2023 u konstatua se:

- Vlera e vendimeve gjyqësore të palikuiduara në mbyllje të vitit 2023 ka rezultuar 15,252,450 lekë, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023, duke sjellë kështu një

nënvlerësim në këtë vlerë të paraqitjes së detyrimeve të prapambetura. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, pika 42.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27 - 46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës në Bashkinë Belsh të merren masat që të njihet dhe kontabilizohet vlera prej 15,252,450 lekë, që i takon vendimeve gjyqësore të palikuiduara duke kryer veprimet debitim i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kreditim i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

### *Me mbylljen e pasqyrave viti 2024*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Belsh nga auditimi mbi saktësinë e llogaritjes së amortizimit të aktiveve, u konstatua se llogaritja e amortizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale, pjesë e llogarive 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” dhe 218 “Inventari ekonomik” për vitin 2023, nuk është zbatuar saktë për të gjitha aktivet afatgjata materiale, si rrjedhojë e mos përdorimit të normave të sakta të amortizimit, sipas llojit specifik të aktivitetit dhe sipas rregullave të llogaritjes së tij për secilën kategori aktivesh. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, pika 36.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27 - 46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Belsh, me qëllim paraqitjen reale të amortizimit dhe raportimit financiar të llogarive 214 dhe 218 të klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, të marrë masat që të llogaritet amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale duke përdorur normat e sakta të amortizimit sipas llojit specifik të aktivitetit dhe sipas rregullave të llogaritjes së tij, për secilën kategori aktivesh sipas kuadrit ligjor dhe udhëzimit përkatës.

### *Me mbylljen e pasqyrave viti 2024*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Belsh nuk janë hartuar grupe pune për të identifikuar asetet që janë në pronësi të Bashkisë Belsh, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale përkatëse asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë dhe Njësi Administrative që përmbledh kjo Bashki. Si rrjedhojë e këtij fakti rezulton se, asetet e paidentifikuara që janë në pronësi të Bashkisë Belsh dhe Njësi Administrative të saj nuk janë pasqyruar si pjesë e llogarisë 210 “Toka, troje, Terene”, duke sjellë kështu një vlerë të nënvlerësuar përsa i takon asetëve të përfshira në këtë llogari. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar; Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”; dhe VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, pikat 9, 10, 11 dhe 22.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27 - 46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Belsh, të formojë grupet e punës për të realizuar identifikimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha pronave të inventarizuara dhe të transferuara në



pronësi të Bashkisë dhe gjithashtu Sektori i Financës të marrë masa për kontabilizimin e tyre si pjesë e llogarisë 210 “Toka, troje, Terene”.

### ***Menjëherë***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 në Bashkinë Belsh bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 73 – 120 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, rezultoi se:

- Procesi i inventarizimit të aktiveve nuk është kryer i plotë, kjo për faktin se pas fazës së inventarizimit fizik nuk është hartuar urdhër për fazën e vlerësimit të aktiveve, si dhe nuk është përcaktuar komisioni përkatës që ka kryer vlerësimin, për të vijuar më tej me fazat e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjесimin sipas rastit dhe nevojës.

- Nuk është hartuar dhe miratuar një raport i inventarizimit fizik, që të përshkruajë kushtet e ruajtjes së aktiveve, duke specifikuar se cilat aktive pas mbarimit të procesit të inventarizimit fizik kanë rezultuar të dëmtuara, të amortizura ose plotësisht të amortizuara etj. Pra nuk ka pasur një verifikim fizik dhe cilësor për aktivet, pjesë e inventarit të vitit 2023, gjë e cila pengon edhe verifikimin e gjendjes konkrete të aktiveve, krahasuar me rezultatin e aktiveve që mbahen në librat e financës dhe kontabilitet.

- Gjithashtu është evidentuar edhe mungesa e një procesverballi vlerësimi, pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve, si dhe nuk është hartuar një relacion i vlerësimit me qëllim përshkrimin e gjithë procedurës së ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet etj.

- Për procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk është hartuar urdhër për fillimin e këtij procesi si dhe nuk është përcaktuar komisioni përkatës që do të realizojë këtë fazë të procesit të inventarizimit.

- Nuk është hartuar një procesverbal për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve për vitin 2023.

- Përsa i takon aktiveve nuk është përgatitur dhe miratuar një regjistër aktivesh i përditësuar si dhe nuk është hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, faqe 27 - 46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1.Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës në Bashkinë Belsh të merren masat që në vijimësi:

- Procesi i inventarizimit të kryhet i plotë duke mundësuar realizimin e të gjitha fazave të procesit të inventarizimit, si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në Bashkinë Belsh janë transferuar asetet e pronave, të njësisve administrative dhe asetet e ekonomive pyjore/kullosore në administrim të bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, por ende nuk janë krijuar grupet e punes për marrjen në dorëzim, administrimin dhe inventarizimin e tyre, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore, për administrimin e aseteve dhe fondit pyjor/kullosor publik për detyrimin e regjistrimit të pronave në regjistrat kadastral publik. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqe 47 - 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1.Rekomandimi:** Titullari i Institucionit në bashkinë Belsh, të formojë grupet e punës për marrjen në dorëzimin e plotë të pronave të inventarizuara, të transferuara në favor të tyre dhe të vijojë procesin për regjistrimin e aseteve të pronave dhe sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullësor në Agjencitë Shtetërore të Kadastrës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik të aseteve të pasurive të paluajtshme.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi taksimin e subjekteve që tregtojnë karburante për taksën e autorizimit nga bashkia, rezultojnë aktivitetet 18 subjekte për detyrimin prej 18,000,000 lekë. Nga kjo vlerë është bërë e mundur të likuidohet nga subjektet vlera 10,300,000 lekë duke mbetur për likuidim vlera **7,700,000 lekë për 10 subjekte**.

Konstatohet se 5 subjekte ushtrojnë aktivitetet pa u pajisur me autorizim ose pa rifreskuar autorizimin, të cilët nuk kanë mundur dhe likuidimin e detyrimit të ngarkuar në autorizimet e kaluara për vlerën 4,600 lekë.

Nga Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është ndërmarrë asnjë masë për pajisjen e tyre me licencë me qëllim arkëtimin e detyrimeve, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9 dhe VKB për miratimin e paketës Fiskale, për vitin 2023. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1.6 faqe 21 - 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i të ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës prej **7,700,000 lekë ndaj 9 subjekteve**, si dhe të bëjë bllokimin e veprimtarisë së tyre deri në likuidimin dhe pajisjen ose rifreskimin me autorizim përkatës për ushtrimin e aktivitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me llogaritjen dhe likuidimin e TNI për objektet në proces legalizimi dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Elbasan (ish- ALUIZNI-t Elbasan), dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Elbasan, rezultojnë se për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezultojnë nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **32 persona** me vlerë **1,099,220 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Belsh.**

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1.6 faqe 21 - 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i të ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Belsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës prej **1,099,220 lekë** ndaj **32 subjekteve**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave të paraqitura nga Sektori i të Ardhurave vendore Bashkia Belsh rezulton se, detyrimet totale që i kanë palët e treta Bashkisë është në vlerën 100,550,451 lekë, si vijon:

- Detyrimet nga biznesi i madh/ vogël	<b>8,890,013 lekë;</b>
- Detyrimet nga abonentët familjarë taksa tarifa	<b>5,737,120 lekë;</b>
- Detyrimet nga abonentët familjarë për taksë tokë	<b>74,939,410 lekë;</b>
- Detyrimet nga subjektet që tregtojnë karburante	<b>7,700,000 lekë;</b>
- Detyrimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	<b>1,099,220 lekë;</b>
- Detyrimet nga dhënia me qera e sipërfaqeve pyjore	<b>2,184,688 lekë.</b>

Nga detyrimi i mësipërm prej **100,550,451 lekë**, vlera prej **89,566,543 lekë** përbën detyrime nga taksa dhe tarifa vendore. Nga vlera totale e borxhit tatimor, Bashkia ka njohur dhe kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitin 2023 vlerën prej 55,524,044 lekë, e cila përbën detyrim për arkëtim. Në krahasim me vitin 2022, borxhi është rritur për vlerën 4,811,488 lekë. Gjithashtu evidentohet dhe fakti se për vitin 2023 janë mbyllur subjekte pa bërë të mundur likuidimin e detyrimeve fiskale, kjo për 33 subjekte me vlerë 3,002,840 lekë. Ekzistojnë debitorë pa shpresë arkëtimi 6 subjekte me vlerë 1,629,977 lekë dhe debitorë mbi 5 vite për 9 subjekte me vlerë 1,441,868 lekë.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia (Sektori i të Ardhurave Vendore ), për vitin 2023 është kërkuar në zbatim të ligjit vetëm bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, për 69 subjekte me vlerë 6,491,151 lekë ose 4% e totalit të detyrimeve që ka kjo Bashki, duke mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër në zbatim të dispozitave ligjore. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB-në nr. 69, datë 21.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Belsh”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1.6 faqe 21 - 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i të ardhurave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë Bashkia Belsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës prej **100,550,451 lekë** duke ulur vlerën e totalit të detyrimeve që ka Bashkia Belsh.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave të paraqitura nga Sektori i të Ardhurave vendore Bashkia Belsh rezulton se vlera totale prej **89,566,543 lekë**, përbën detyrime nga taksa dhe tarifa vendore. Nga ky total Bashkia Belsh nuk ka njohur dhe kontabilizuar vlerën prej **34,041,499 lekë, e cila do të konsiderohet e ardhur e munguar**. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 69, datë 21.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Belsh”, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017

